



RAPORT

I

KËSHILLIT KOMBËTAR TË RADIOS DHE TELEVISIONIT PËR VEPRIMTARINË E ZHVILLUAR

GJATË VITIT 2011

Shkurt, 2012

I.	VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM.....	5
II.	RREGULLIMI DHE MBIKËQYRJA E VEPRIMTARISË RADIOTELEVIZIVE PUBLIKE DHE PRIVATE NË PËRPUTHJE ME KUADRIN LIGJOR.....	7
2.1.	VENDIMMARRJA e KKRT-së, LICENCIMI DHE ECURIA E OPERATORËVE TË LICENCUAR.....	7
2.2.	SANKSIONET NDAJ SUBJEKTEVE	14
2.3.	EKZEKUTIMI I VENDIMEVE TË KKRT-së	15
2.4.	ÇËSHTJET GJYQËSORE.....	16
2.5.	RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË TRANSMETIMIT	16
III.	PROGRAMACIONI.....	21
3.1.	SITUATA PROGRAMORE NË MEDIAN ELEKTRONIKE	21
3.2.	STUDIO E MONITORIMIT	24
3.3.	PROGRAMET INFORMATIVE	27
3.3.1.	Raportet kohore për pasqyrimin e veprimtarisë së subjekteve politike dhe institucioneve nga radiot dhe televizionet.....	28
3.3.2.	Raportet kohore për subjektet politike dhe institucionet - Koha sinkron viti 2011	29
3.3.3.	Raportet kohore për temën e lajmit.....	30
3.3.4.	Raportet kohore për aktorët “sinkron”.....	33
3.3.5.	Monitorimi i fushatës zgjedhore.....	33
3.3.6.	Mbi zbatimin e kërkesave ligjore për transmetimin e reklamave	34
IV.	RRJETET E TRANSMETIMIT DHE MBULIMI ME SINJAL I ZONAVE TË LICENCIMIT.....	35
4.1.	PLANIFIKIMI I SPEKTRIT TË FREKUENCAVE.....	35
4.1.1.	Planifikimi i rrjeteve numerike	35
4.1.2.	Planifikimi i bandës FM.....	35
4.1.3.	Shfrytëzimi i dividendit digjital për shërbime të tjera të telekomunikacioneve.	38
4.1.4.	Planifikimi i rrjeteve analoge.....	39
4.2.	MONITORIMI I SHFRYTËZIMIT TË SPEKTRIT TË FREKUENCAVE	42
4.2.3.	Operatorë radio e televizivë privatë vendorë të transmetimeve analoge tokësore dhe televizione kabllorë që u është hequr licenca se kanë ndërprerë transmetimet apo nuk kanë dalë në transmetim mbas licencimit.....	43
4.2.4.	Operatorë radiofonikë privatë vendorë që kanë pasur ndërprerje të shpeshta të transmetimit.....	44
4.3.	TRANSMETIME TË PALICENCUARA (SHFRYTËZIM I PAAUTORIZUAR I SPEKTRIT)	44
4.3.1.	Transmetimet e “Vizion+”	44
4.3.2.	Transmetimet e Klan TV	44

4.3.3.	Transmetimet TV ABC News.....	44
4.3.4.	Operatori televiziv vendor TV JUG.....	45
4.3.5.	Transmetim sinjali televiziv analog i palicencuar	45
4.3.6.	Transmetimet e “RealTV”	45
4.3.7.	Rritje e paaautorizuar e fuqisë së transmetimit.....	45
4.3.7.2.	Transmetimet e TV Elrodi Music, Vorë	45
4.3.8	Rrjete kabllore të palicencuar.....	47
4.3.9	Transmetime numerike të paaautorizuara në kanalet e licencuara	48
4.3.10.	Transmetimet numerike të paaautorizuara.....	48
4.4.	OPERATORËT.....	48
4.4.1.	Operatorët radio e televizivë që mbështeten në rrjete tokësore analoge.	48
4.4.1.1.	Televizioni publik	48
4.4.1.2.	Operatorët privatë kombëtarë	54
4.4.1.2.1.	Operatori Kombëtar TV KLAN.....	55
4.4.1.2.2.	Operatori Kombëtar TV TOP CHANNEL	58
4.4.1.3.	Operatorët privatë vendorë	63
4.4.2.	Transmetimet numerike ekzistuese.....	64
4.4.2.1.	Digitalb	64
4.4.2.2.	Tring.....	67
4.4.2.3.	Shijak TV	68
4.5	Puna për përfundimin e projektit të Strategjisë së kalimit në transmetimet numerike.....	70
V.	MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE, MARRËDHËNIET ME JASHTË DHE PUBLIKUN	71
5.1.	MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE ADMINISTRATIVE..	71
5.2.	Marrëdhëniet me jashtë.....	73
5.3.	Pjesëmarrja në projektin “Televizioni dixhital i Europës juglindore (SEE DIGITV)”	77
5.4.	Marrëdhëniet me publikun dhe grupet e interesit	80
VI.	BUXHETI DHE REALIZIMI I TREGUESVE FINANCIARË	81
6.1.	REALIZIMI I OBJEKTIVAVE KRYESORE TË PUNËS	82
6.2.	GJOBAT	89
6.3.	BASHKËPUNIMI ME DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË TATIMEVE	89
VII.	KONKLUSIONE.....	89
VIII.	ANEKSET	90
ANEKSI I -	Sanksionet ndaj subjekteve.....	90
ANEKSI II -	Urdhrat për bllokimin me vulosje dhe sekuestrimin e pajisjeve.....	110
ANEKSI III-	Çështjet gjyqësore.....	111
ANEKSI IV-	Pasqyra e detyrimeve të operatorëve privatë radio e televizione për vitin 2010.....	123
ANEKSI V-	Pasqyra e detyrimeve të operatorëve.....	124
ANEKSI VI -	MBULIMI I OPERATOREVE TELEVIZIVE PËR VITIN 2011	
ANEKSI VII -	MBULIMI I OPERATOREVE RADIO PËR VITIN 2011 (VOLUMI 2)	

I. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Institucioni i KKRT-së, në fushën e mediave elektronike, po luan gjithnjë e më shumë një rol të dukshëm në jetën ekonomike të vendit dhe pritet së afërmi një kontribut edhe më i madh, si rrjedhojë e zhvillimeve të rëndësishme teknologjike dhe ekonomike në fushën e transmetimeve televizive. Interesi publik për stabilitetin, sigurinë dhe zhvillimin e fushës së mediave elektronike mbetet i veçantë edhe për shkak të problematikave që ka pasur kjo fushë në të shkuarën, problematika të cilat ende nuk janë zgjidhur tërësisht.

Me gjithë mjetet modeste në dispozicion, KKRT ka mundur të përmbushë disa nga misionet e saj në drejtim të një rregullimi pozitiv të sektorit. Gjithsesi, pavarësisht përpjekjeve dhe arritjeve pozitive, zhvillimi dhe konsolidimi i veprimtarisë në këtë fushë është përballur me sfida dhe vështirësi të shumta të cilat janë të pranishme edhe sot. Këto vështirësi dhe problematika kanë qenë të lidhura kryesisht me boshllëqet në legjislacionin ekzistues, mosrespektimin e konkurrencës së ndershme në tregun e mediave elektronike, problemet me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtës së autorit (veçanërisht të të drejtave të transmetimit) etj.

Ndryshimet e vullshme të teknologjisë në fushën e medias, realiteti aktual i televizionit numerik në Shqipëri dhe nevoja për të përditësuar legjislacionin në fuqi në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira evropiane në këtë fushë, duhet të shërbejnë si një nxitje e fuqishme për miratimin sa më të shpejtë të kuadrit të nevojshëm ligjor, që do të përcaktojë rrugët e këtij procesi, me synimin për të krijuar një ambient dhe vizion afatgjatë të qasjeve rregulluese.

Edhe gjatë vitit 2011 nuk u bë i mundur miratimi i dy dokumenteve bazë: a. *Strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike* dhe b. *Projektligjit "Per mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë"*, të cilat do të përcaktojnë modalitetet dhe mënyrat e kalimit në sistemin numerik. Vonesa e miratimit të këtyre dy dokumenteve themelore, mund të rrezikojë realizimin e detyrimeve brenda afateve të përcaktuara. Miratimi sa më i shpejtë i tyre do të plotësojë kuadrin e nevojshëm ligjor për ndërmarrjen e hapave konkrete të kalimit në sistemin e transmetimeve numerike.

Gjithashtu, një handicap i madh mbetet momenti në të cilin projektligji do të miratohet, për sa kohë nuk është miratuar akoma Strategjia për kalimin nga transmetimi analog në atë numerik. Në këtë aspekt, do të ishte e nevojshme të mirëkoordinohet procesi i miratimit të Strategjisë së kalimit në transmetimet numerike, me procesin e miratimit të ligjit të ri që rregullon sektorin audioviziv.

Kalimi në sistemin numerik, përbën një objektiv të interesit të përgjithshëm që nuk mund të arrihet pa një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet të gjitha palëve të interesuara. Ky objektiv duhet të jetë, ndoshta pikënisja për të ngritur një proces të përpunimit të një politike publike që të garantojë më mirë efikasitetin e tij.

Kalimi në transmetimet numerike mund të ngadalësohet nëse ky kalim i lihet plotësisht mekanizmave të tregut. Ndërhyrjet e sektorit publik janë të dobishme në

aspektin e rregullimit, të mbështetjes financiare për konsumatorët, për fushatën informuese apo mbështetëse për të kapërcyer dobësi të njohura të tregut.

Raporti i Komisionit Evropian mbi situatën në Shqipëri (nëntor 2011), për sa i përket fushës së medias, theksonte nevojën e forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve administrative, teknike dhe financiare, me qëllim realizimin e plotë dhe në kohë të atyre hapave që do të kërkonte kalimi në sistemin numerik.

Pavarësisht problemeve dhe vështirësive të hasura, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, edhe gjatë vitit 2011, ka ndërmarrë një sërë aktesh, veprime dhe veprimtari konkrete, të cilat pasqyrohen në mënyrë të hollësishme në këtë raport.

II. RREGULLIMI DHE MBIKËQYRJA E VEPRIMTARISË RADIOTELEVIZIVE PUBLIKE DHE PRIVATE NË PËRPUTHJE ME KUADRIN LIGJOR

2.1. Vendimmarrja e KKRT-së, licencimi dhe ecuria e operatorëve të licencuar.

Gjatë vitit 2011, nga ana e KKRT-së, janë miratuar gjithsej 296 Vendime.

Vendimmarrja e KKRT-së është fokusuar kryesisht në dhënien e licencave për transmetime radiotelevizive, rinovimet e licencave të subjekteve të ndryshme, shqyrtimin e ankesave të tyre ndaj sanksioneve me gjobë, çështjet e vlefshmërisë së licencave.

Sipas dispozitave të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 që rregullon veprimtarinë radiotelevizive, një ndër kompetencat kryesore të KKRT-së, është dhënia dhe heqja e licencës subjekteve privatë.

Gjatë vitit 2011, është vënë re një rritje e numrit të kërkesave nga ana e subjekteve për t'u licencuar si operatorë radiofonikë privatë vendorë. Po ashtu interes i dukshëm është shfaqur edhe për pajisjen me licencë si operatorë televizivë privatë kabllorë. Kështu gjatë 2011 KKRT ka licencuar gjithsej 43 subjekte radiotelevizive, nga të cilët: Operatorë televizivë privatë analogë vendorë (3 subjekte), operatorë radiofonikë analogë privatë vendorë (11 subjekte) dhe operatorë televizivë privatë kabllorë (29 subjekte), konkretisht si më poshtë vijon:

TV Analogë Vendorë

1. TV Vendor “ADRIAMED” (Rrethi Durrës);
2. TV Vendor “Best” (Qarku Elbasan);
3. TV Vendor “UTV Education” (zgjerim zone licencimi qarqet Elbasan-Korçë)

Radio Analoge Vendore

1. Radio “ABC NEWS” (Rrethet Tiranë-Durrës, qyteti Fier dhe qarku Vlorë);
2. Radio “Epiri” (Rrethi Gjirokastrë);
3. Radio “Dimension” (Rrethi Shkodër);
4. Radio “Hit FM” (Rrethi Elbasan);
5. Radio “Univers” (qarqet Tiranë-Durrës-Fier-Vlorë);
6. Radio “Number One” (qarqet Tiranë-Durrës-Fier-Vlorë);
7. Radio “Sprint” (Rrethi Gjirokastrë);
8. Radio “City Radio Albania” (rrethet Tiranë-Durrës);
9. Radio “Clazz” (qarqet Tiranë-Durrës-Fier-Vlorë);
10. Radio “Albania FM” (zgjerim zone licencimi në rrethet Tiranë-Durrës);

11. Radio “7 Nord” (Rrethi Shkodër)

TV Kabllorë

1. TV Kabllor “Tepelena Sat” (zgjerim zone licencimi në Komunën Ksamil);
2. TV Kabllor “Lapardha” (Komuna Otlak);
3. TV Kabllor “ARD&NET” (Komuna Frakull);
4. TV Kabllor “Mamurras” (Qyteti Mamurras);
5. TV Kabllor “Orexh” (Komuna Mbrostar dhe fshati Patos);
6. TV Kabllor “Alfa Hajdini” (Fshati Afrim i Ri);
7. TV Kabllor “Xhaçi” (zgjerim zone licencimi në Qytetin Bilisht);
8. TV Kabllor “Zargoçan” (fshati Zargoçan);
9. TV Kabllor “2ASL” (Komunat Shirgjan dhe Funar);
10. TV Kabllor “Pirg” (Komuna Pirg);
11. TV Kabllor “Brado” (Komuna Bradashesh);
12. TV Kabllor “Masa Group” (Komunat Vreshtas dhe Pirg);
13. TV Kabllor “Korça” (zgjerim zone licencimi në Komunat Drenovë, Libonik, Bulgarec dhe Mollaj);
14. TV Kabllor “Fokus” (zgjerim zone licencimi në Komunën Pirg);
15. TV Kabllor “Cable Albania Gjirokastrë” (qyteti Gjirokastrë);
16. TV Kabllor “Cable Albania Kombi” (qyteti Fier);
17. TV Kabllor “Cable Albania Lushnjë” (qyteti Lushnjë);
18. TV Kabllor “Cable Albania Elbasan North” (qyteti Elbasan);
19. TV Kabllor “Cable Albania Elbasan South” (qyteti Elbasan);
20. TV Kabllor “Cable Albania Kavajë” (qyteti Kavajë);
21. TV Kabllor “Cable Albania Durrës” (qyteti Durrës);
22. TV Kabllor “Cable Albania Tiranë” (qyteti Tiranë);
23. TV Kabllor “Cable Albania Shkodër” (qyteti Shkodër);
24. TV Kabllor “Epiri 2011” (qarku Gjirokastrë);
25. TV Kabllor “K.A.M” (zgjerim zone licencimi në Komunën Gjocaj);
26. TV Kabllor “I-Miri Cable” (rrethi Korçë);
27. TV Kabllor “APT” (zgjerim zone licencimi në qytetin Himarë);
28. TV Kabllor “CA-TV Përmet” (qyteti Përmet);
29. TV Kabllor “ERGI” (Komunat Rrashbull dhe Shënvllash);

Një ndër detyrat e KKRT-së është edhe identifikimi i përfundimit të afatit të vlefshmërisë së licencës të subjekteve që ushtrojnë veprimtari radiotelevizive. Në mbështetje të nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 kërkesa për rinovimin e licencës bëhet 90 ditë përpara afatit të përfundimit të saj. Pas shqyrtimit të aplikimit të subjekteve për rinovimin e licencës, KKRT ka miratuar rinovimin e licencës për 48 subjekte.

Sipas rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, gjatë shqyrtimit të kërkesave për rinovimin e

licencave është realizuar verifikimi i respektimit të kriterëve si: realizimi i mbulimit të zonës së licencimit (sipas territorit dhe sipas popullsisë), respektimi i kushteve të licencës për sa i përket programeve; detyrimet financiare për periudhën e ushtrimit të aktivitetit si dhe zbatimi i legjislacionit në përgjithësi dhe veçanërisht të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar.

Subjektet radiotelevizivë, të cilëve u është rinovuar licenca gjatë vitit 2011, janë si më poshtë vijon:

Rinovim licencash për TV Vendore (22 subjekte)

1. “TV Skampa”;
2. “TV Onufri”;
3. “TV Puka”
4. “TV Kombi”;
5. “Tv Klaudiana”;
6. “TV ARV”;
7. “TV 4+”;
8. “TV Mati”;
9. “TV Kruja”;
10. “TV Berati”;
11. “Club TV”;
12. “TV A1”;
13. “TV Lezha”
14. “TV 6+1”;
15. “TV Elrodi”;
16. “TV Blue Sky”;
17. “TV Telesport”;
18. “TV Sot 7”;
19. “TV M+”;
20. “TV ABC News”;
21. “TV 6”;
22. “TV Amantia”.

Rinovim licencash për radio private vendore (14 subjekte)

- a. "Radio +3";
- b. "Radio Klea";
- c. “Radio Magic Star”;
- d. “Radio e Parë”;
- e. “Radio Sport”
- f. “Radio Saranda”;
- g. “Radio Maria”;
- h. Radio me përsëritës “World Family”;
- i. Radio me përsëritës “RFI”;
- j. “Boom Boom Radio”;

- k. "Radio Alpo";
- l. "Radio Aldo 03";
- m. "Radio Star";
- n. "Radio 7";

Rinovim licencash për televizione privatë kabllore (12 subjekte)

- 1. "TV Kabllor Lezha";
- 2. "TV Kabllor Ani";
- 3. "TV Kabllor Egnatia";
- 4. "TV Kabllor Elbasat";
- 5. "TV Kabllor Bulqiza";
- 6. "TV Kabllor Kukësi";
- 7. "TV Kabllor Kuçova";
- 8. "TV Kabllor Mati";
- 9. "TV Kabllor HB-CA";
- 10. "TV Kabllor Asparag";
- 11. "TV Kabllor Fokus";
- 12. "TV Kabllor Kruja".

KKRT, mbështetur në kompetencat e veta, ka marrë edhe vendime për mosdhënie licencash, mosrinovim, heqje dhe shpalljen pavlefshmërie të licencave të disa subjekte që nuk kanë përmbushur kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ligj dhe në licencë, apo për subjektet që në përfundim të afatit të licencimit megjithëse janë njoftuar disa herë nuk kanë shfaqur interes për rinovimin e licencës apo kanë pasur mangësi në dokumentacionin e dorëzuar.

Nga ana tjetër, ka pasur edhe subjekte që me kërkesën e tyre, për shkaqe të ndryshme, kanë paraqitur kërkesë për heqje dorë nga licenca, duke e bërë këtë të fundit të pavlefshme.

Mosdhënie licencash

- 1. "TV Kabllor Hysa";
- 2. "TV Kabllor Dyrmo-Gegë";
- 3. "TV Kabllor Arbri";
- 4. "TV Kabllor Sean";
- 5. "TV Kabllor Fier-Shegan";
- 6. "TV Kabllor Këmishtaj";
- 7. "TV Kabllor Vraniger";
- 8. "Radio Visare";
- 9. "Radio Fokus";
- 10. "Radio Supersonic";
- 11. "Radio Channel 7";
- 12. "Radio Blu";
- 13. "Radio Rock 88";

14. "Radio 44";
15. " U.A.T. Radio";
16. "Radio Ndërkombëtare e Tiranës";
17. "Radio Motiv"

Mosrinovim licencash me pasojë pavlefshmërinë e tyre

1. "Radio House of Arts"; (mosshlyerja e detyrimeve financiare)
2. "TV Dardan"; (mosrespektim i kushteve teknike të licencës)
3. "Radio Lezha"; (mangësi në dokumentacionin e paraqitur)
4. "TV Kabllor Përmeti"; (mangësi në dokumentacionin e paraqitur)
5. "TV Kabllor AL-TE"; (mosshlyerja e detyrimeve financiare)
6. "TV Kabllor Poliçani"; (mangësi në dokumentacionin e paraqitur)

Heqje ose pavlefshmëri licencash

1. "TV Tele 1"; (shkelje e kushteve të licencës)
2. "Radio Armonia"; (mungesë interesi)
3. "Radio Prespa"; (mungesë interesi)
4. "TV Kabllor K8"; (me kërkesë të subjektit)
5. "Radio Deutschewelle" (me kërkesë të subjektit)
6. "Tv Durrësi" (shkelje e kushteve të licencës)
7. "TV Armonia"; (mungesë interesi)
8. "TV Gramshi"; (mungesë interesi)
9. "Radio me përsëritës Italia"; (mungesë interesi)
10. "Radio ABC" (mungesë interesi)

Vendimet e KKRT-së për dhënie, mosrinovimin dhe heqjen apo pavlefshmërinë e licencave janë botuar në Fletoren Zyrtare, sipas detyrimit të parashikuar në ligjin organik.

Ndaj vendimeve të KKRT-së, për mosdhënie licence, është paraqitur kërkesë-padi, në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë, vetëm nga një subjekt ("Shoqëria Visare" sh.p.k.). Po ashtu, gjykata e rrethit gjyqësor Tiranë është investuar nga 3 subjekte radiotelevizivë për mosrinovimin e licencës (Radio House of Arts, TV Dardan) dhe bërjes së pavlefshme të licencës (subjekti televiziv privat vendor TV Tele 1).

Gjithashtu, gjatë vitit 2011 nga ana e KKRT-së, janë marrë në shqyrtim njoftimet e paraqitura nga subjektet lidhur me ndryshimet në të dhënat e paraqitura në kërkesën për marrjen e licencës nga subjektet e licencuara. Sipas nenit 30 të ligjit, subjektet janë të detyruar të njoftojnë KKRT-në për çdo ndryshim të të dhënave të paraqitura në kërkesën për marrjen e licencës si ndryshimet në strukturën e ortakëve në rast se subjektet janë të organizuar në formën e shoqërive anonime apo shoqërive me përgjegjësi të kufizuar, në administrimin e shoqërisë, emërtimin e subjektit radioteleviziv, ndryshime në strukturën programore, selinë apo adresën e

subjektit dhe të tjera kushte që kanë ndryshuar të subjekti, që nga momenti i dhënies së licencës.

Gjatë vitit 2011, KKRT ka marrë në shqyrtim kërkesat e 16 subjekteve për shqyrtimin e ndryshimit të të dhënave të paraqitura dhe ka miratuar 15 prej tyre, si vijon:

1. Me Vendimin nr. 67, datë 11. 02. 2011, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në licencën e televizionit privat vendor “TV K8” (ndryshimin e emërimit të kanalit televiziv në “Riviera”).
2. Me Vendimin nr. 68, datë 11. 02. 2011, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në subjektin televiziv privat kabllor “Tepelena Sat” (kalimin e të drejtave të licencës së këtij subjekti personit privat fizik Dritan Memushi dhe zgjerimin e zonës së licencimit të këtij subjekti).
3. Me Vendimin nr. 69, datë 11. 02. 2011, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në subjektin televiziv privat kabllor “TV Kabllor Lissus” (kalimin e të drejtave të licencës së këtij subjekti shoqërisë “Reçi KGM” dhe zgjerimin e zonës së licencimit të këtij subjekti).
4. Me Vendimin nr. 70, datë 11. 02. 2011, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në licencën e subjektit televiziv privat kabllor “TV Kabllor Fokus” (ndryshime në strukturën e ortakëve të shoqërisë, largimin e ortakut Klevis Lumshi, shtimin e ortakut Naun Prifti me 20% të kuotave, shtimin e kuotave për ortakun Dudu Bici me 80% të kuotave, ndryshimin e administratorit të shoqërisë dhe ndryshimin e emrit të subjektit).
5. Me Vendimin nr. 71, datë 11. 02. 2011, KKRT ka miratuar ndryshimin e emërimit (logos) të “Radio Take 5” në “Radio Vesa”.
6. Me Vendimin nr. 180, datë 31.05.2011, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në licencën e subjektit radiofonik privat vendor “Radio Alsat 1” (ndryshime në strukturën e ortakëve të shoqërisë, shtimin e ortakut Rezart Taçi, me 100% dhe ndryshimin e administratorit të shoqërisë).
7. Me Vendimin nr. 203, datë 30. 06. 2011, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në licencën e subjektit radiofonik privat vendor “Radio Maria” (ndryshime në strukturën e ortakëve të shoqërisë, largimin e ortakut Julian Priska dhe shtimin e ortakut Prenka Lazraj).
8. Me Vendimin nr. 204, datë 30. 06. 2011, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në licencën e subjektit radiofonik privat me përsëritës “Radio World family” (ndryshime në strukturën e ortakëve të shoqërisë, largimin e ortakut Julian Priska dhe shtimin e ortakut Prenka Lazraj).
9. Me Vendimin nr. 205, datë 30. 06. 2011, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në licencën e subjektit radiofonik privat vendor “Radio Alfa” (ndryshime në strukturën e ortakëve të shoqërisë, largimin e ortakut Arben Kote dhe shtimin e ortakut Dritan Sejko me 100% të kuotave, si dhe ndryshimin e emërimit të subjektit në “Radio Albania FM” dhe ndryshimin e selisë së shoqërisë).

10. Me Vendimin nr. 206, datë 30.06.2011, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në licencën e subjektit televiziv privat kabllor “TV Kabllor Pojan” (ndryshimi i pronësisë kalimi i të drejtave të licencës tek subjekti person fizik Haki Trakalaci).
11. Me Vendimin nr. 220, datë 25.07.2011, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në licencën e subjektit televiziv privat vendor “TV News 24” (ndryshime në strukturën e ortakëve të shoqërisë, pas të cilit ortak me 100% të kuotave është shoqëria “Focus Group” sh.p.k., ndryshimi i emrit të shoqërisë në “Focus Media News” dhe ndryshimin e administratorit të shoqërisë).
12. Me Vendimin nr. 257, datë 03. 10. 2011, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në licencën e subjektit televiziv privat vendor “TV Ora News” (ndryshimin e formës ligjore të subjektit në shoqëri anonime, ndryshimin në pronësinë e kuotave sipas të cilit aksionarë të shoqërisë janë Redon Ndroqi me 8% të aksioneve, Ylli Ndroqi me 52% të aksioneve dhe Mimoza Ndroqi me 40% të aksioneve, si dhe ndryshimin e administratorit të shoqërisë).
13. Me Vendimin nr. 281, datë 30. 11. 2011, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në licencën e subjektit televiziv privat vendor “TV Rozafa” (ndryshimin e emrit të shoqërisë në “Media Motiv” dhe ndryshimin e emërimit të kanalit televiziv në “TV Media Motiv”).
14. Me Vendimin nr. 293, datë 30. 12. 2011, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në licencën e subjektit radiofonik privat vendor “Radio Eurostar Music” (ndryshimin e administratorit të shoqërisë).
15. Me Vendimin nr. 294, datë 30. 12. 2011, KKRT ka miratuar ndryshimin e të dhënave në licencën e subjektit televiziv privat vendor “Club TV” (ndryshimin në pronësinë e kuotave të shoqërisë sipas të cilit aksionarë të shoqërisë janë Arben Bylykbashi me 66.88% të aksioneve, Fahrije Bylykbashi me 33.12% të aksioneve dhe ndryshime në përbërjen e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës).

Në kuadër të respektimit të qëllimit të ligjvënës, për parandalimin e situatave të monopolit në fushën e medias elektronike, si dhe mbështetur në kufizimet e parashikuara në nenin 20 të ligjit nr. 8410, datë 30. 09. 1998, i cili parashikon kufizime, si në pjesën e aksioneve që mund të zotërojë një aksioner në një operator radioteleviziv kombëtar, ashtu edhe në numrin e licencave që mund të marrë një operator radioteleviziv, nga ana e KKRT-së, me Vendimi nr. 47, datë 21.01.2011 është vendosur mosmiratimi i ndryshimeve në të dhënat e paraqitura nga shoqëria “Teknotrade” sh.p.k. Për këtë shoqëri, të licencuar për subjektin televiziv privat vendor “Tele 1”, gjatë procedurës administrative është konstatuar se aksionar me 100% të kuotave ishte shtetasi Ylli Ndroqi, i cili rezultonte të ishte, po ashtu, ortak me 100% të aksioneve në shoqërinë “Ora” sh.p.k., licencuar nga KKRT për subjektin televiziv privat vendor “Ora”.

Ky Vendim mbështetej në nenin 20 të ligjit nr. 8410, datë 30. 09. 1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në RSH”, i ndryshuar, që përcakton kufizimet e

pronësisë në subjektet që licencohen nga KKRT-ja për transmetim radioteleviziv dhe më konkretisht parashikohet se: *“... I njëjti subjekt që zotëron një licencë për transmetim televiziv vendor mund të marrë vetëm një licencë të dytë për transmetim radioje vendore.”*

Gjithashtu ky vendimi u mor edhe për mbrojtjen e konkurrencës së ndershme (një ndër kompetencat e KKRT-së në mbështetje të pikës 4 të nenit 7 të ligjit nr. 8410 datë 30. 09. 1998, i ndryshuar).

KKRT, në ushtrimin e funksioneve vendimmarrëse dhe si autoritet rregullator në fushën e veprimtarisë radiotelevizive, ka realizuar kontrollet përkatëse të mbulimit territorial të të gjithë subjekteve të licencuara zona e licencimit të të cilëve bie ndesh me kërkesën e parashikuar në nenin 20 të ligjit, sipas të cilit *me termin “transmetim televiziv apo radio vendore”, sipas këtij ligji nënkuptohet mbulimi me sinjal televiziv ose radio nga operatorët televizivë ose radioje të licencuar, si të tillë, i territorit të komunave, bashkive, deri në hapësirën administrative të dy prefekturave (zona e transmetimit), kur ato formojnë një entitet gjeografik dhe...*” dhe në respektim të parimit mbi të drejtën e informimit të parashikuar në Kodin e Procedurave Administrative, ka njoftuar zyrtarisht subjektet, zona e licencimit e të cilëve do t’i nënshtrohet ridimensionimit, për të sjellë zonën e mbulimit në harmoni me ligjin.

Lidhur me sa më sipër, KKRT, me vendimin nr. 154, datë 29. 04. 2011, ka vendosur të saktësojë zonën e licencimit të subjektit televiziv privat vendor “UTV Education” dhe vazhdon procedura për subjektet “TV Ora”, “TV Apollon”, “Radio RASH”, “Radio Maria”, “Radio Club FM”, “Radio Eurostar” dhe “Radio Eagle”.

2.2. Sanksionet ndaj subjekteve

Ndër detyrat më të rëndësishme të KKRT-së është edhe kontrolli i veprimtarisë që ushtrohet nga subjektet e licencuara për respektimin e kushteve të licencës. Shkeljet e dispozitave të kushteve të licencave, apo akteve normative, përbëjnë kundërvajtje administrative, për të cilat parashikohen edhe sanksionet përkatëse. Inspektimi i veprimtarisë së të licencuarve, realizohet nga inspektorët e KKRT-së të cilët kanë të drejtë të vendosin sanksione me gjobë bazuar në nenin 137/4 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar, ndërsa në zbatim të nenit 137/3 të ligjit kanë të drejtë t’i propozojnë Këshillit: reduktimin, pezullimin ose heqjen e licencës së një subjekti radioteleviziv, kur konstatohet shkelje e dispozitave të parashikuara ligjore. Po ashtu, vetë KKRT ka kompetencë të vendosë sanksione në bazë të nenit 137 për subjektet që veprojnë në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Në zbatim të dispozitave të mësipërme janë kryer inspektime të shpeshta tek operatorët e licencuar, por gjithashtu janë konstatuar edhe dalje në transmetim të subjekteve të ndryshëm pa licencë. Në rastet kur janë konstatuar shkelje të ligjit dhe kushteve të licencës, ndaj subjekteve kundërvajtës janë ndërmarrë sanksionet përkatëse.

Pjesa më e madhe e kundërvajtjeve administrative, për të cilat janë marrë edhe sanksionet përkatëse, gjatë vitit 2011 kanë konsistuar në transmetime pa të drejta

(pirateri), shkeljen e kushteve të licencës së miratuar (mosrespektim i zonave të licencimit, transmetime në frekuenca të tjera të paautorizuara, etj). Në krahasim me vitet paraardhëse, gjatë vitit 2011, vihet re një ulje e numrit të operatorëve privatë radiotelevizivë kabllorë që kanë dalë në transmetim pa autorizimin/licencimin e KKRT-së. Për shkeljet e konstatuara, krahas sanksioneve me gjobë, në rastet e daljeve në transmetim pa licencë, janë nxjerrë urdhrat që i janë dërguar për zbatim Drejtorive Tatimore, me qëllim mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve apo sekuestrimin e pajisjeve të këtyre subjekteve. Me hollësisht sanksionet me gjobë pasqyrohen në Aneksin 1 të këtij Raporti.

2.3. Ekzekutimi i vendimeve të KKRT-së

Një tjetër çështje, që ndikon drejtpërdrejt në ecurinë normale të institucionit, është ekzekutimi i vendimeve të miratuara nga KKRT. Duke qenë se organika e institucionit të KKRT-së nuk ka struktura të veta të ngarkuara për ekzekutimin e vendimeve, ligji nr. 8410, datë 30. 09. 1998, i ndryshuar, për zbatimin e tyre ka parashikuar bashkëpunimin me organe të tjera. Më konkretisht, vendimet e KKRT-së, ekzekutimi i të cilave kërkon patjetër mbështetjen e institucioneve të tjera janë vendimet për miratimin e sanksioneve me gjobë ndaj subjekteve që ushtrojnë veprimtari radiotelevizive, vendimet për heqjen e licencave, apo vendimet për mbylljen e stacioneve transmetuese dhe sekuestrimin e pajisjeve transmetuese.

Përveç sa më sipër, edhe vjelja e detyrimeve financiare (taksë dhe pagesë për licencë) e subjekteve radiotelevizivë, në rast se nuk kryhet në mënyrë vullnetare, sërish duhet të ekzekutohet nga organet tatimore.

Sipas legjislacionit nenit 137/5, të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar, organi shtetëror i ngarkuar për ekzekutimin e vendimeve të KKRT-së (duke pasur parasysh edhe ndryshimet në ligjin “Për procedurat tatimore”), janë Drejtoritë Rajonale Tatimore. Në zbatim të këtij detyrimi ligjor, midis KKRT-së dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, është nënshkruar marrëveshja e re e bashkëpunimit, e cila ka hyrë në fuqi në datën 01. 01. 2011. Neni 2 i marrëveshjes përcakton objektin e kësaj marrëveshjeje pikërisht rregullimin e bashkëpunimit midis palëve, me qëllim mbështetjen e strukturave të KKRT-së lidhur me ekzekutimin e vendimeve të marra ndaj subjekteve që shkelin legjislacionin e fushës.

Por, me gjithë nënshkrimin e kësaj marrëveshje, ku janë përcaktuar modalitetet e detyrimit e secilës prej palëve nënshkruese, edhe gjatë vitit 2011 vazhdon të jetë problem ekzekutimi i vendimeve të KKRT-së. Në zbatim të legjislacionit të sipërpërmendur, nga ana e KKRT-së, i janë përcjellë, shkresërisht, për ekzekutim Drejtorive Rajonale Tatimore, vendimet e KKRT-së, duke ofruar rast pas rasti edhe prezencën fizike të inspektorëve të KKRT-së.

Por, ashtu si edhe në vitet e mëparshme, gjatë vitit raportues, pjesa dërrmuese e vendimeve të KKRT-së nuk janë ekzekutuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, duke sjellë efekte negative për situatën financiare të KKRT-së si edhe uljen e autoritetit të KKRT-së si organ rregullator në fushën audiovizuale dhe, për

pasojë, edhe mosgarantimin e objektivave të KKRT-së për garantimin e konkurrencës së ndershme në tregun mediatik shqiptar.

Neglizhencë e organeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në mosekzekutimin e vendimeve të KKRT-së konstatohet veçanërisht lidhur me Vendimet e KKRT-së për bllokimin e aktivitetit transmetues të subjekteve radiotelevizivë të palicencuar nga KKRT (kryesisht TV kabllorë). Edhe kur organet tatimore realizojnë mbylljen e këtyre subjekteve të palicencuar nga KKRT, kemi të bëjmë thjesht me një mbyllje formale të tyre, pasi me largimin e organeve tatimore, subjektet kundërvajtës rifillojnë menjëherë aktivitetin e tyre të paligjshëm. Për sa i përket urdhrave të KKRT-së për sekuestrimin e pajisjeve transmetuese të subjekteve kundërvajtës, pasi janë ezauruar afatet ligjore për bllokimin e tyre, organet tatimore janë plotësisht pasivë në ekzekutimin e tyre. Gjithashtu, kjo neglizhencë konstatohet dhe në ekzekutimin e sanksioneve me gjobë të vendosura nga KKRT. Theksojmë se të ardhurat që merren nga vjelja e gjobave derdhen në buxhetin e shtetit dhe jo atë të KKRT-së.

Gjatë vitit 2011 janë identifikuar një numër i konsiderueshëm subjektsh televizivë privatë, kabllorë apo analogë, që kishin dalë në transmetim pa autorizimin e licencimin e KKRT-së. Në mbështetje të neneve 10/a, 137/2 dhe 137/5 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, janë miratuar urdhrat për bllokimin me vulosje dhe sekuestrimin e pajisjeve transmetuese, të cilat i janë dërguar për ekzekutim organeve tatimore. Lista e urdhrave pasqyrohet në Aneksin 2 të këtij Raporti.

2.4. Çështjet gjyqësore

Duke pasur parasysh parimin kushtetues të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, subjektet e ndryshme radiotelevizivë, që pretendojnë se u janë cenuar të drejtat, i janë drejtuar gjykatës. Po ashtu, edhe vetë KKRT ka vënë në lëvizje gjykatën në cilësinë e palës paditëse.

KKRT aktualisht, është e përfshirë në total në 63 procese gjyqësore, nga të cilat 20 janë në proces gjykimi në gjykatat e shkallës së parë, 19 janë në proces gjykimi në gjykatat e apelit dhe 22 janë në proces shqyrtimi në Gjykatën e Lartë. Shumica e këtyre proceseve gjyqësore janë çështje të nisura në vitet e mëparshme, por proceset gjyqësore janë mbartur edhe në vitin 2011.

Një pasqyrim i çështjeve gjyqësore, që aktualisht janë në gjykim në të tre shkallët e gjyqësorit, por edhe mbi çështjet gjyqësore të përfunduara gjatë vitit 2011, jepet në Aneksin 3 të këtij Raporti.

2.5 Respektimi i të drejtave të transmetimit.

Mbrojtja dhe respektimi i pronësisë intelektuale përbën një nga detyrimet që Shqipëria duhet të plotësojë në kuadër të akteve ndërkombëtare, të cilat janë nënshkruar nga ana e Shqipërisë. Një nga momentet kyçe të vendit drejt rrugës së integritetit europian është nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, marrëveshje e cila i ka kushtuar një vëmendje të posaçme mbrojtjes që Shqipëria duhet t'i sigurojë pronësisë intelektuale. Më konkretisht, neni 73 i MSA-së parashikon që Shqipëria duhet të marrë masat e duhura për të siguruar një nivel mbrojtjeje për pronësinë intelektuale, të njëjtë me atë të siguruar nga vendet e BE-së. Këshilli Kombëtar i Radio Televizionit është një nga institucionet i cili ka si detyrë funksionale monitorimin dhe mbrojtjen e një prej degëve të pronësisë intelektuale, konkretisht të të drejtave të autorit. KKRT vepron në një fushë të kufizuar për mbrojtjen e të drejtave të autorit, specifikisht të drejtat e transmetimit. Në ligjin nr. 8410, datë 30.09.1998, "Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 40/1 "Detyrimi për depozitimin e dokumentacionit të së drejtës së transmetimeve", parashikon se *"Operatorët radiotelevizivë transmetojnë programe të prodhuara nga ata vetë, në bashkëprodhim me të tjerë, me marrëveshje me kontratë shitjeje, shkëmbimi ose dhurimi. Operatorët radiotelevizivë detyrohen të identifikojnë, me figurë ose me zë, si dhe të dokumentojnë programet e përcaktuara në paragrafin e parë, duke përcaktuar llojin e programit, realizuesin dhe zotëruesin e pronësisë mbi programin. Operatorët radiotelevizivë të licencuar detyrohen të depozitojnë pranë Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit dokumentacionin që vërteton se zotërojnë të drejtën e transmetimit të programeve me marrëveshje me kontratë shitjeje, shkëmbimi ose dhurimi"*.

Në bazë dhe për zbatim të ligjit organik të KKRT-së, kjo e fundit ka nxjerrë Rregulloren "Mbi depozitimin e dokumentacionit për të drejtën e transmetimit" (me Vendimin nr. 165, datë 29. 08. 2003). Bazuar në pikën 3 e vijim të kësaj rregulloreje *"Të gjithë subjektet radiotelevizivë të depozitojnë pranë KKRT-së dokumentacionin e të drejtës së transmetimeve të programeve radiotelevizive, qofshin këto programe të prodhuara vetë, në bashkëprodhim me të tjerë apo me marrëveshje (kontrate shitje, shkëmbimi, dhurimi). Kur është e nevojshme, duhet të depozitohet dhe marrëveshja origjinale nga e cila buron e drejta e shitjes, shkëmbimit apo dhurimit"*. Kjo rregullore përcakton procedurat dhe mënyrat e dorëzimit të dokumentacionit lidhur me të drejtat e transmetimit pranë KKRT-së.

Shkelja apo mosrespektimi i dispozitave të mësipërme, nga ana e subjekteve radio-televizive, përbën kundërvajtje administrative dhe KKRT, në mbështetje të pikës 7 të nenit 137/4, të ligjit nr. 8410, datë 30. 09. 1998, i ndryshuar, ka të drejtë të vendosë *"Gjobë nga 200.000 deri në 1.000.000 lekë, kur transmetojnë programe që nuk i kanë prodhuar vetë dhe për të cilat nuk kanë marrëveshje, kontratë shitjeje, shkëmbimi ose dhurimi nga subjektet e tjera radiotelevizive, prodhuesit*

apo shpërndarësit e autorizuar të tyre. Gjopa vendoset nga KKRT-ja me nismën e saj ose pas ankimit të operatorëve. Përsëritja e kësaj shkeljeje më shumë se 5 herë dënohet me uljen deri në 50 për qind të afatit të licencës. Në rast ripërsëritjeje shkelja ndëshkohet me heqjen e licencës. Ndëshkimi me gjobat e mësipërme është i vlefshëm edhe për Radio Televizionin Shqiptar”.

Me qëllim arritjen e një mbrojtjeje sa më efektive si dhe për të arritur sa më shumë rezultate në luftën ndaj piraterisë radiotelevizive, institucionet të cilat janë të përfshirë në mbrojtjen e të drejtave të autorit bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë punën ndërmjet tyre. Në këtë kuadër, KKRT dhe Zyra Shqiptare për të Drejtat e Autorit (ZSHDA), si institucion i krijuar me qëllim mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të autorit, kanë nënshkruar një Memorandum Bashkëpunimi. Ky memorandum është nënshkruar më datë 28. 09. 2007 dhe parashikon mënyrat konkrete të bashkërendimit të veprimeve. Me konkretisht në mbështetje të pikës 4 të këtij Memorandumi, dokumentacioni i të drejtave të transmetimit (kontrata shitjeje, shkëmbimi, dhurimi), duhet të regjistrohen dhe çertifikohen më parë në ZSHDA, e më pas të depozitohen në KKRT.

Gjatë vitit 2011 KKRT i ka intensifikuar marrëdhëniet me ZSHDA-në, duke bashkëpunuar në monitorimin dhe garantimin e respektimit të të drejtave të autorit, kryesisht përmes shkëmbimit të informacioneve.

Gjatë vitit 2011, mes operatorëve radiotelevizivë është vënë re një rritje e ndërgjegjësimit lidhur me detyrimet që ata kanë për respektimin e të drejtave të transmetimit/autorit. Megjithatë, transmetimi i programeve radiotelevizive pa të drejta është ende i pranishëm. Ky fenomen është i shtrirë në të gjithë llojet e subjekteve, por mbetet më i theksuar sidomos në operatorët radiotelevizivë kabllorë dhe operatorët radiotelevizivë analogë vendorë. Ashtu siç është theksuar edhe më parë, monitorimi dhe kontrolli i operatorëve radiotelevizivë analogë vendorë mbetet një shqetësim për KKRT-në, pasi sinjali i tyre nuk kapet nga studioja e monitorimit në KKRT.

KKRT, gjatë gjithë vitit 2011, u ka bërë të qartë të gjithë operatorëve radiotelevizivë se dokumentacioni i të drejtave të transmetimit (kontratë shitjeje, shkëmbimi, dhurimi), para se të depozitohet në KKRT nga operatorët radiotelevizivë, duhet të jetë i regjistruar dhe i certifikuar nga ZSHDA. Me gjithë përpjekjet e bëra nga KKRT, pjesa më e madhe e dokumentacionit të depozituar pranë kësaj të fundit vazhdon të jetë i paregjistruar dhe i pacertifikuar nga ZSHDA.

Respektimi i të drejtave të transmetimit dhe të drejtave të autorit vazhdon të mbetet një çështje mjaft e ndjeshme, që jo vetëm ndiqet me mjaft vëmendje nga KKRT, por edhe do të vazhdojnë të ndiqet në të ardhmen e afërt. Kjo për shkak se pronësia intelektuale është një fushë e re në Shqipëri dhe praktika e konsoliduar lidhur me të mungon.

Disa nga faktorët që ndikojnë në kontrollin efektiv të KKRT-së lidhur me respektimin e të drejtave të transmetimit, janë si vijon: Pjesa më e madhe e subjekteve radiotelevizivë nuk monitorohen nga Tirana, por nëpërmjet inspektimeve, çka e bën garantimin e të drejtës së autorit të vështirë. Pirateria televizive ekziston, në një masë më të konsiderueshme, te subjektet radiotelevizivë që operojnë në zona të thella dhe që janë larg mbikëqyrjes e monitorimit të KKRT-së.

Nga ana tjetër, pamundësia për të verifikuar burimin e vërtetë të mbajtësit të së drejtës së autorit, të vërtetësisë dhe origjinalitetit të kontratave, apo të të drejtave që realisht zotërojnë shoqëritë e ndryshme distributore, vështirësojnë punën e KKRT-së në këtë drejtim.

KKRT, pavarësisht vështirësive që ndesh gjatë veprimtarisë së saj, gjatë vitit 2011 ka intensifikuar inspektimet në terren, nëpër të gjithë territorin e vendit për të mbikëqyrur respektimin e të drejtave të transmetimit nga ana e subjekteve televizivë kabllorë. Si rezultat i kontrolleve të ushtruara gjatë gjithë vitit janë ndëshkuar me sanksionin e paralajmërimit dhe të gjobës një numër i konsiderueshëm televizioneve kabllore dhe/ose vendore të cilat ka rezultuar se kanë shkelur të drejtat e transmetimit. Në krahasim me vitin 2010 janë rritur kontrollet e inspektimet dhe rrjedhimisht edhe sanksionet e marra për shkeljet e konstatuara të të drejtave të transmetimit.

Konkretisht, gjatë vitit 2011, KKRT ka vendosur 58 sanksione me gjobë dhe 46 sanksione me paralajmërim (bashkëlidhur Aneksi 1 ku janë përfshirë sanksionet ndaj subjekteve gjatë vitit 2011).

Studioja e Monitorimit në KKRT ndihmon në luftën kundër piraterisë duke kryer dhe vënë në dispozicion monitorimin e programeve të subjekteve radiotelevizivë analogë që operojnë në Tiranë dhe Durrës. Megjithatë, Studioja e Monitorimit pranë KKRT-së, për shkak të pamundësisë teknike dhe infrastrukturës së kufizuar që ka, nuk mund të bëjë në shkallë masive një monitorim të tillë. Vazhdojnë akoma të mbeten jashtë monitorimit programor të gjithë subjektet radiotelevizive analogë vendorë jashtë zonës së licencimit Tiranë e Durrës; platformat numerike tokësore, që aktualisht veprojnë në territorin shqiptar; të gjithë subjektet televizivë kabllorë, përfshirë edhe ata që veprojnë në Tiranë.

Sigurimi i fondeve për zgjerimin dhe pajisjen me aparatet teknike të nevojshme të Studios së Monitorimit, për të kapur sinjalin e të gjithë operatorëve radiotelevizivë që operojnë në Republikën e Shqipërisë, do të ishte një ndihmë mjaft e madhe dhe gjithashtu një ndër zgjidhjet në funksion të të drejtave të transmetimit.

KKRT, në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale 2010-2015, ka rritur bashkëpunimin me të gjitha institucionet e përfshira në mbrojtjen e pronësisë

intelektuale. Lidhur me të drejtat e transmetimit, KKRT ka intensifikuar bashkëpunimin me ZSHDA, si institucioni kryesor i cili monitoron dhe kontrollon respektimin e të drejtave të autorit, si dhe me Agjencitë e Administrimit Kolektiv.

Një numër i konsiderueshëm problemesh, që kanë të bëjnë me të drejtat e transmetimit dhe të autorit, pritet të gjejnë zgjidhje me miratimin e ligjit të ri “Për transmetimet audiovizuale në RSH”. KKRT ka dhënë kontributin e saj gjatë hartimit të projektligjit, për të gjitha çështjet, ndër të tjera edhe për çështjen e të drejtave të autorit.



III. PROGRAMACIONI

Gjatë vitit 2011, nga ana e KKRT-së është ndjekur dhe vizionuar në vijueshmëri programacioni i operatorëve radiotelevizivë kombëtarë dhe i disa operatorëve televizivë vendorë. Kjo veprimtari është kryer në zbatim të ligjit nr. 8410, datë 30. 09. 1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të vendimeve e të rregulloreve të KKRT-së si dhe në përputhje me detyrat funksionale të Drejtorisë së Programeve në KKRT për zbatimin e ligjshmërisë nga ana e operatorëve radiotelevizivë dhe respektimin e parimeve themelore të ushtrimit e zhvillimit të veprimtarisë radiotelevizive, në fushën e përmbajtjes, të gjuhës dhe të etikës së komunikimit në programet radiotelevizive.

3.1. PËRMBAJTJA, STRUKTURA DHE ETIKA NË PROGRAMET RADIOTELEVIZIVE

Për realizimin e këtij synimi, KKRT, përmes vënies në efikasitet të burimeve njerëzore e teknologjike, bashkërendimit e bashkëpunimit të ngushtë me drejtorive e sektorëve përkatës ka monitoruar e ka vizionuar në vijimësi strukturën programore, përmbajtjen, gjuhën dhe etikën e komunikimit të programeve, të llojeve të ndryshme, të operatorëve radiotelevizivë, veçanërisht atyre kombëtarë. Duke pasur për qëllim përmirësimin e vazhdueshëm e rritjen e cilësisë së veprimtarisë radiotelevizive në fushën e përmbajtjes, janë hartuar edhe relacionet, informacionet e propozimet përkatëse, si dhe është vendosur komunikimi institucional me operatorët radiotelevizivë për problematika të ndryshme të fushës së përmbajtjes, të strukturave programore, të zbatimit të ligjit e të deontologjisë së mediave në fushën e programacionit radioteleviziv. Këtij qëllimi i ka shërbyer edhe bashkëpunimi e komunikimi me shoqata profesionistësh të medias televizive e të medias së shkruar, si edhe me publikun. Në këtë drejtim, veçanërisht në raportet e komunikimit me publikun, i është kushtuar vëmendje e posaçme vlerësimit të sugjerimeve e ankesave verbale apo shkresore nga shikues të ndryshëm, organizata joqeveritare, shoqata etj. Përmbajtja dhe problematika e këtyre ankesave, shpesh, ka sugjeruar komunikim e trajtim të veçantë në organe vendimmarrëse, propozime për plotësime e ndryshime në projektligjin e ri për median apo në akte nënligjore, si dhe sensibilizim të opinionit publik.

KKRT, në praktikën e punës për vitin 2011, ka evidentuar edhe prurje e dukuri të reja në fushën e programacionit të operatorëve radiotelevizivë, por më shumë është përqendruar në veçoritë e zhvillimit e konsolidimit të programeve ekzistuese. Te përmbajtja e këtyre programeve, në rastet më të mira, janë vërejtur përpjekje të vazhdueshme për t’i kushtuar më shumë vëmendje arritjes së standardeve të sotme mediatike, të cilat nuk e përjashtojnë, por e theksojnë një nga parimet kryesore të veprimtarisë radiotelevizive të sanksionuar edhe në nenin 35 të ligjit nr. 8410, datë 30. 09. 1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar: karakterin edukativ të programeve dhe respektimin e nenit 10 të Konventës Evropiane “Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.” Besojmë se ndërgjegjësimi në rritje i operatorëve radiotelevizivë për rëndësinë e domosdoshmërinë e parimeve apo kritereve të sipërpërmendura ka sjellë jo vetëm shumëllojshmëri e larmi programesh të ndryshme, por edhe rritje

të cilësisë e të profesionalizmit, zgjerim të gamës së përmbajtjes e përmirësim të elementëve të gjuhës televizive. Janë pikërisht këto programe që, përgjithësisht, njihen e mbeten nga më të ndjekurat, kanë pasur e vijnë të kenë audiencë të konsiderueshme. E shprehur me terma të tjerë, kjo do të thotë se ato kanë teleshikuesin e tyre “besnik”, përveç të tjerash, edhe sepse përmes tyre realizohet, jo si qëllim në vetvete, por si rrjedhojë organike, funksioni edukues e formues i medias së lirë, funksioni informues, pluralist e i paanshëm, i gërshtuar me një gjuhë komunikimi me standarde etike e profesionale bashkëkohore. Pra, në tërësinë e tyre, këto programe realizojnë cilësisht, një detyrim e funksion të rëndësishëm të operatorëve publikë e kombëtarë, atë formues dhe edukativ, krahas atij informues, kulturor e argëtues.

Ndër programe të tilla, të konsoliduara me vlera të qëndrueshme nga viti në vit, të realizuara e të transmetuara nga operatorët radiotelevizivë kombëtarë, edhe gjatë vitit 2011, mund të përmendim programet “Njerëz të humbur”, “Log”, “Duel”, “7 x 7”, si dhe “Festivali i Këngës” në Radiotelevizionin Publik, programet “E diela shqiptare”, “Opinion”, “Kënga magjike”, “Këngët e shekullit”, “Histori me zhurmues”, “Maratona e këngës popullore”, në televizionin kombëtar “Klan”; programet “E diell”, “Top Fest”, “Top Story”, “Selekt”, “Shqip”, “Pasdite në Top Channel”, në televizionin “Top Channel”. Për vlera të përmbajtjes, të problematikës dhe të cilësisë së realizimit e transmetimit, mund të përmenden edhe programe të realizuara nga televizione vendore si “Dita ime”, “Zonë e ndaluar”, e “Histori dashurie” në televizionin “Vizion plus”, apo “Koha night news” në televizionin “Koha”.

KKRT vlerëson se në hullinë e programeve të mësipërme, të realizimeve më të mira e të vlerësuara nga publiku e nga kritika televizive në shtypin e shkruar, edhe pse më të pakta në numër, janë edhe programet e reja, që hynë në transmetim për herë të parë gjatë vitit 2011, si “Voice of Albania” e “100 milionë”, (televizioni “Top Channel”), “Takimi i pasdites”, “Promozonë” e “Kush do të bëhet milioner” (televizioni “Klan”), “Sketch show”, “Debat”, “Next 2011”, (televizioni “Vizion plus”) etj. Përmbajtja e problematika, mënyra e trajtimit, pjesëmarrja e gjerë e publikut, ndjeshmëria ndaj çështjeve të mprehta të shoqërisë, edukimi përmes argëtimit, shfrytëzimi i arritjeve të reja të teknologjisë i bëjnë këto programe dinamike, cilësore, me një kontribut të konsiderueshëm në realitetin mediatik të vendit tonë.

Nga ana tjetër, KKRT ka konstatuar dhe është ndalur në disa lloj programesh, kryesisht programe argëtuese e komerciale, të cilat për arsye nga më të ndryshmet, renditen ndër programet më të ndjekura, por me probleme të herëpashershme të keqpërdorimit të gjuhës e të komunikimit televiziv, me shkelje të kërkesave e të normave morale dhe etike të shoqërisë e të etikës së komunikimit në ekran. Raste të kësaj natyre, qoftë edhe sporadike, janë vënë re në programe si “Big Brother”, apo me një frekuencë më të dendur në variete e spektakle televizive si “Portokalli”, (televizioni “Top Channel”) apo emisione si “Zonë e Lirë” (televizioni “Vizion Plus” dhe televizioni “Klan”).

Nisur nga raste të tilla dhe nga ndjeshmëria e publikut ndaj çështjeve të etikës shoqërore e televizive, nga KKRT dhe administrata e saj janë bërë përpjekje të vazhdueshme për kualifikimin dhe njohjen e deontologjisë së mediave, duke u

ballafaquar me kërkesat e direkt se BE-se për mediat (AVMSD) në këtë fushë dhe me përvojat më të përparuara bashkëkohore. Shumë çështje të trajtimit të përmbajtjes specifike të programeve, të deontologjisë e të normave etike e morale kërkojnë interpretim e gjykim të mbështetur në argumente profesionalë, jo vetëm të fushës së medias elektronike. Për këto çështje është diskutuar në Këshillin Kombëtar të Radios dhe Televizionit, duke arritur në vendimmarrje kolegjiale, gjithnjë në interes të publikut e në zbatim të ligjit, por pa cenuar pavarësinë editoriale të operatorëve radiotelevizivë ku janë vënë re raste të shkeljes e cenimit të dinjitetit e privatësisë së individëve, të keqpërdorimit të dhunës e të temave të seksit, ose shkelje të tjera të etikës e të moralit qytetar. Në këtë drejtim, nga ana e KKRT-së, janë iniciuar dhe janë propozuar masat përkatëse për shkelje të etikës e gjuhës së komunikimit televiziv, për mosrespektim të të drejtave të të miturve e adoleshentëve në emisionin “Zonë e lirë”, (televizioni “Vizion plus” dhe televizioni “Klan”); për përmbajtje të dëmshme e shkelje etike në *programet e natës* në televizionin “Tirana TV”; për moszbatim e mospërputhje të *strukturës programore* sipas licencës nga ana e televizionit “A1” etj. Përveç trajtimit e komunikimit për këto çështje me operatorët televizivë përkatës, KKRT, pas sondazheve e vizionimeve të programeve sipas llojeve e zhanreve, ka propozuar dhe ka hartuar kujtesa me tematikë të veçantë, për të gjithë operatorët radiotelevizivë, si “Kujtesë për mbrojtjen e privatësisë së fëmijëve në edicionet informative”, “Kujtesë për respektimin e normave të gjuhës letrare kombëtare në programet televizive”, projekt – memorandum i bashkëpunimit me Qendrën e Studimeve Albanologjike; etj. Një pjesë e këtyre materialeve janë bërë publike edhe përmes bashkëpunimit me sektorin e marrëdhënieve publike, në drejtorinë përkatëse në KKRT, duke i publikuar në faqen elektronike të KKRT-së. Jemi të mendimit se pas miratimit të shpejti të ligjit të ri “Për transmetimet me zë e figurë në Republikën e Shqipërisë”, ku është përfshirë një nen i rëndësishëm për veprimtarinë e Këshillit të Ankesave, problematikat e diskutueshme të përmbajtjes së programeve që lidhen kryesisht me etikën e komunikimit televiziv dhe ndikimin e saj në publik do të marrin një zgjidhje gjithnjë e më institucionale, në përputhje me standardet profesionale bashkëkohore.

Gjatë vitit 2011, administrata e KKRT-së, në mënyrë të përsëritur, ka kryer sondazhe për të verifikuar përputhjen e strukturave programore të operatorëve radiotelevizivë sipas licencave përkatëse, duke i krahasuar me programacionin aktual, ditor dhe javor. Përveç rastit të sipërpërmendur, të televizionit “A1”, përgjithësisht, rezulton se operatorët radiotelevizivë i respektojnë strukturat e miratuara, madje edhe i përmirësojnë ato, në përputhje me rritjen e mundësive financiare e potencialet teknike e profesionale, me kërkesat e tregut e të shijeve të publikut. Megjithatë, kjo është një çështje që nuk mund të trajtohet vetëm formalisht. Në thelb, programacioni është përmbajtje dhe cilësia e vlera e programeve, të çfarëdo lloji a natyre qofshin, përcaktohet pikërisht nga respektimi i parimeve themelore të veprimtarisë radiotelevizive, të konceptuara natyrshëm në gjithë dinamikën e tyre dhe të ndihmuara e të plotësuara nga të gjithë aksesoret e tjerë të domosdoshëm të një programi radioteleviziv.

Më konkretisht, kjo e vërtetë, në panoramën mediatike shqiptare, mund të ilustruhet me gjendjen e paraqitjen e programacionit për fëmijë e të rinj. Pa e cenuar aspak lirinë e përzgjedhjes e të drejtën e programimit e të transmetimit nga çdo operator radioteleviziv, na duhet të theksojmë, në mënyrë të përsëritur, se

programacioni për fëmijë është ende i mangët, rastësor, i pjesshëm e fragmentar, duke mos arritur të përmbushë kërkesat e teleshikuesve të vegjël e të rinj. Dy-tre shembuj realizimesh cilësore si “Gjeniu i vogël” (Televizioni “Klan”), “1001 pse” (televizioni “Top Channel”), apo “Perform fest” (në TVSH) janë tepër pak për të përmbushur detyrimin dhe përgjegjësinë e madhe, profesionale dhe qytetare, që kanë televizionet kombëtare (dhe jo vetëm ato) kundrejt formimit dhe edukimit të shëndetshëm moral e mendor të fëmijëve. Nga sondazhet dhe vizionimet e bëra për këtë qëllim, Drejtoria e Programeve konkludon se nuk është nevoja për “përmbysje” apo risi në strukturën programore të operatorëve radiotelevizivë kombëtarë, por për një qasje më të përgjegjshme, për njohje dhe vlerësim gjithnjë e më e lartë të domosdoshmërisë së programacionit cilësor e të drejtpërdrejtë për fëmijët, në platformat e grilat programore. Kjo gjë bëhet më evidente pasi vendin kryesor në programacionin për fëmijë e zënë ende filmat e animuar, shpesh të përsëritur në ritransmetime të shumta, të vjetra e të njohura, pa interes për grupmoshat e fëmijëve që i kanë parë nga viti, në vit, nga njëri ekran në tjetrin. Megjithatë, një dukuri pozitive, që duhet evidentuar është se, përgjithësisht, në programet për fëmijë respektohet etika dhe, veçanërisht në programet e Radiotelevizionit Publik Shqiptar, gjuha, si element shumë i rëndësishëm i programeve, është e përshtatshme për grupmoshat të cilave u drejtohet. Kjo gjë, siç u vu re më sipër, nuk mund të thuhet për të gjitha programet e tjera, që u drejtohen të rriturve, por mund të ndiqen nga fëmijët, për shkak të përmbajtjes, interesave, rastësisë apo edhe kohës së transmetimit. Ndaj jemi të mendimit se, në fushën e etikës së programeve televizive, aktet e kodet etike ku duhet të mbështetet veprimtaria e secilit operator radioteleviziv nuk duhet të jenë thjesht formale, por të respektojnë norma etiko-morale tradicionale e bashkëkohore të shoqërisë shqiptare, duke shfrytëzuar edhe njohjen e përvojës më të përparuar evropiane në këtë fushë.

3.2 STUDIO E MONITORIMIT

Gjatë vitit 2011, Drejtoria e Programeve në KKRT i ka kushtuar një vëmendje të posaçme zbatimit të detyrimeve ligjore si dhe funksionimit efikas, mbështetur në rregulloren përkatëse, të Studios së Monitorimit, si një nga sektorët më të rëndësishëm, që ka për objekt kryesor monitorimin e edicioneve informative të operatorëve radiotelevizivë, si dhe të programeve të llojeve të ndryshme, në përgjithësi.

Në këtë studio, për regjistrimin e operatorëve televizivë, që transmetojnë e shihen në qytetin e Tiranës (gjithsej 27), janë në funksion 15 kompjuterë regjistruar, që, sipas një plani mujor të përcaktuar regjistrojnë programet e transmetuara nga ora 11⁰⁰ deri në 07⁰⁰ të ditës së nesërme, për t’u ristartuar përsëri në 11⁰⁰. Në regjistrim të vazhdueshëm janë televizionet kombëtare (TVSH, Klan, TCH) dhe 12 televizione të tjera që ndryshojnë sipas rasteve. Për sa i takon radiove regjistrohen me kaseta edicionet e lajmeve të dy radiove kombëtare (Radio Tirana dhe Top Albania Radio) dhe sipas rastit, edhe radio të tjera, sinjali i të cilave kapet në Tiranë (gjithsej 49). E shprehur në terma statistikorë, në Studion e Monitorimit, gjatë vitit 2011, janë regjistruar gjithsej **rreth 81 000 orë transmetimi** (15 orë/ditë x 30 ditë x 12 muaj x 15 kompjuterë).

Është vënë re se, pas rikonstruksionit të Studios së Monitorimit në vitin 2009 dhe përmirësimit të teknologjisë së ruajtjes dhe kalimit të të dhënave në server, koha e bërjes efektive të informacionit për përpunim është e tillë që nuk përbën pengesë në rezultatin, efikasitetin dhe cilësinë e punës së specialistëve monitorues. Materialet e regjistruara ruhen në 2 serverë me kapacitet rreth 950 GB së bashku si dhe në 3 hard disqe të jashtme me kapacitet rreth 900 GB secili. Pra, në tërësi, kapaciteti ruajtës i studios është rreth 2700 GB, që në terma kohorë është afërsisht 2 muaj informacion i ruajtur në gjendje për t'u përpunuar më tej. Në këtë pikë mund të themi që pjesa e kapacitetit ruajtës, të Studios së Monitorimit, është edhe pika e dobët e saj, pasi mundësitë ruajtëse të informacionit të regjistruar janë të kufizuara. Këtë vit do të vihet në shfrytëzim një server i ri që do ta rrisë pjesërisht kapacitetin e Studios së Monitorimit, por, sipas mendimit tonë, zgjidhjen përfundimtare do ta arrinim me një rikonstruksion të plotë të teknologjisë aktuale.

Në funksion të monitorimit të edicioneve informative, dhe të programeve të tjera të llojeve të ndryshme, funksionojnë 6 poste monitorimi. Specialistët monitorues në këto poste realizojnë detyrat ditore, të përcaktuara sipas një plani të hartuar që në fillim të muajit, ose detyra të tjera funksionale, që dalin nga kërkesat, bashkëpunimi e bashkërendimi i punëve me sektorët e tjerë të Drejtorisë së Programeve apo drejtori të tjera në KKRT. Ndër to mund të përmendim bashkëpunimin e vazhdueshëm me Drejtorinë Juridike e të Licencave, sidomos për monitorim programesh me problematika të ndryshme në fushën e të drejtave të autorit e të drejtave të transmetimit të programeve të blera.

Në terma statistikorë, në Studion e Monitorimit janë monitoruar, gjatë vitit 2011, rreth 1800 edicione informative (5 edicione/ditë x 30 ditë x 12 muaj). Gjithashtu, gjatë këtij viti është bërë monitorimi i programeve për televizionet kryesore që shihen në qytetin e Tiranës, në lidhje me respektimin e strukturës së tyre programore, sipas licencave përkatëse. Gjatë vitit 2011 janë monitoruar:

Subjekti i monitoruar	TVSH	KLAN	TOP CHANNEL	VIZION PLUS	TELE 1	KOHA	MUZIKORE
Orë programesh të monitoruara	3000	3000	3000	3000	2000	800	500

Në periudha të caktuara të vitit, është kryer monitorimi i operatorëve të caktuar televizivë, sipas natyrës së programeve që ato transmetojnë, si p. sh: Monitorim i televizioneve që transmetojnë vetëm muzikë (në muajin qershor, tetor), monitorim programesh në lidhje me plotësimin e të drejtave të autorit, monitorim reklamash të transmetuara nga një televizion i caktuar (televizioni Tele 1), monitorim i programeve të caktuara që transmetohen në disa televizione (programe me karakter muzikor, muaji dhjetor), monitorim i televizioneve me karakter informativ (muaji shtator) etj. Gjithashtu, gjatë vitit 2011, është bërë nga Studio e Monitorimit edhe monitorimi i programeve të radiove që transmetojnë në qytetin e Tiranës, në lidhje me respektimin e strukturës programore për të cilën ato janë licencuar (në muajt prill, tetor, nëntor).

Një detyrë mjaft e rëndësishme, e realizuar nga Studioja e Monitorimit në KKRT, në periudhën prill - maj 2011, ishte angazhimi i saj në monitorimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet vendore. Në mbështetje të Kodit Zgjedhor, monitorimi i pasqyrimin të fushatës zgjedhore në median elektronike, bëhet nga Bordi i Monitorimit të Medias (BMM). Angazhimi i Studios së monitorimit ishte maksimal në përshtatjen e metodologjisë së monitorimit, trajnimin e personelit të monitoruesve, përgatitjen e teknikës së nevojshme dhe infrastrukturës përkatëse në Studion e Monitorimit të KKRT-së etj.

Gjatë fushatës zgjedhore janë monitoruar edicione lajmesh si më poshtë:

Nr	Subjekti	Monitoruar
1	NEWS 24	12. ⁰⁰ – 24. ⁰⁰
2	ORA NEWS	12. ⁰⁰ – 24. ⁰⁰
3	NESËR	12. ⁰⁰ – 24. ⁰⁰
4	ABC	12. ⁰⁰ – 24. ⁰⁰
5	A1	12. ⁰⁰ – 24. ⁰⁰
6	TOP NEWS	12. ⁰⁰ – 24. ⁰⁰
7	UFO	12. ⁰⁰ – 24. ⁰⁰

Nr	Subjekti	Monitoruar
1	TVSH	3 edicione lajmesh
2	KLAN	3 edicione lajmesh
3	TOP CHANNEL	3 edicione lajmesh
4	ALSAT	3 edicione lajmesh
5	KOHA	3 edicione lajmesh
6	PLANET	3 edicione lajmesh
7	SHIJAK	3 edicione lajmesh
8	VIZION PLUS	3 edicione lajmesh

KKRT e realizoi këtë proces në bashkëpunim me Bordin e Monitorimit të Medias, i ngritur nga KQZ-ja, i cili, në bazë të Kodit Zgjedhor, për kryerjen e monitorimit, shfrytëzoi kapacitetet teknike të KKRT-së.

3.3 PROGRAMET INFORMATIVE

KKRT ka realizuar në vijimësi, edhe gjatë vitit 2011, monitorimin e edicioneve informative të transmetuara nga operatorët radiotelevizivë kombëtarë. Po ashtu, sipas kërkesave ligjore, është mbikëqyrur edhe transmetimi i reklamave nga disa operatorë radiotelevizivë.

Operatorët kombëtarë, që monitorohen në vazhdimësi janë: TVSH, Tv Klan, Top Channel, Radio Tirana, Top Albania Radio. Si rregull rezultatet e monitorimit të edicioneve informative u janë bërë të njohura institucionit të Presidentit, Kryeministrit, Kryetares së Kuvendit, Këshillit të Ministrave, Komisionit Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në Kuvendin e Shqipërisë si dhe gjithë subjekteve mediatike të monitoruara. Këto rezultate u janë paraqitur edhe partive politike parlamentare si dhe institucioneve ndërkombëtare që ushtrojnë aktivitet në vendin tonë.

Në fillim të çdo muaji rezultatet e monitorimit të edicioneve informative bëhen të njohura edhe përmes publikimit në faqen zyrtare të KKRT-së.

Tabelat e monitorimit përcaktojnë të dhëna statistikore mbi kohën e vënë në dispozicion nga operatorët radiotelevizivë në edicionet informative, për veprimtaritë e partive politike, institucioneve shtetërore dhe të pavarura, aktorëve të ndryshëm politikë dhe social ekonomike etj. Po ashtu, jepen të dhëna të hollësishme mbi prezencën sinkron të personaliteteve politike dhe shtetërore në ekranet televizive dhe mikrofonat e radios.

Gjatë monitorimit janë përcaktuar të dhëna lidhur me vendin që kanë zënë në edicionet e lajmeve tema të tilla si politika, lajmet ndërkombëtare, ekonomia, veprimtaritë e Parlamentit, të qeverisë, arsimit, arti dhe kultura, kronika e zezë, shëndetësia, kriminaliteti, biznesi, sporti etj.

Në materialin e monitoruar çdo muaj përfshihet edhe një pasqyrë mbi qëndrimin e operatorëve të ndryshëm për të njëjtin lajm. Lidhur me këtë, në tabelën “Raportet kohore për temën e lajmit” duken tendencat e këtyre operatorëve ndaj favorizimit të forcave të ndryshme politike apo edhe ndaj fenomeneve të caktuara sociale, politike apo të biznesit.

3.3.1 Raportet kohore për pasqyrimin e veprimtarisë së subjekteve politike dhe institucioneve nga radiot dhe televizionet

Raportet kohore për subjektet politike dhe institucionet - Koha e plotë viti 2011 (Tabela)

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit					
Raport i Drejtorisë së Programeve për Edicionet Informative					
Koha e Plotë për Subjektet Politike dhe Institucionet Qendrore (koha në %)					
Viti 2011					
Subjektet/Operatori	Top Channel	TV Klan	TVSH	Radio Tirana	Top Albania Radio
Presidenti	6.64%	2.29%	2.95%	6.13%	7.46%
Kryeministri	16.54%	29.21%	30.09%	27.83%	17.40%
Qeveria	10.04%	20.12%	24.73%	22.91%	10.18%
Parlamenti	7.69%	6.87%	9.17%	12.41%	9.61%
Partia Demokratike	9.05%	15.63%	16.74%	10.55%	10.28%
Partia Socialiste e Shqipërisë	39.86%	14.44%	8.44%	12.49%	32.43%
Lëvizja Socialiste për Integrim	3.00%	6.94%	5.56%	4.90%	4.58%
Partia Republikane	0.41%	0.44%	0.51%	0.07%	0.13%
Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut	0.62%	0.18%	0.00%	0.12%	0.44%
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	0.95%	0.89%	0.88%	0.87%	2.10%
Aleanca Demokratike	0.00%	0.19%	0.08%	0.00%	0.00%
Lëvizja Demokristiane	0.15%	0.00%	0.00%	0.00%	0.16%
Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	0.08%	0.00%	0.00%	0.00%	0.15%
Partia Agrare Ambientaliste	0.00%	0.02%	0.10%	0.04%	0.00%

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT

Partia Bashkimi Liberal Demokrat	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Partia Demokracia Sociale e Shqipërisë	0.30%	0.86%	0.03%	0.09%	0.25%
Partia Demokristiane	0.06%	0.13%	0.04%	0.03%	0.08%
Partia e Ballit Kombëtar	0.16%	0.00%	0.00%	0.02%	0.18%
Partia e Ballit Kombëtar Demokrat	0.00%	0.00%	0.09%	0.05%	0.00%
Partia G99	0.16%	0.06%	0.08%	0.00%	0.07%
Partia Lëvizja e Legalitetit	0.02%	0.20%	0.09%	0.05%	0.08%
Partia për Ligj dhe Drejtësi	0.09%	0.09%	0.10%	0.05%	0.13%
Partia Socialdemokrate e Shqipërisë	2.64%	0.24%	0.04%	0.37%	1.39%
Partia Socialiste 91	0.71%	0.09%	0.00%	0.06%	0.59%
Partia Komuniste e Shqipërisë	0.05%	0.52%	0.04%	0.00%	0.02%
Partia Pensioniste	0.00%	0.14%	0.00%	0.00%	0.10%
Shuma	100%	100%	100%	100%	100%

3.3.2. Raportet kohore për subjektet politike dhe institucionet - Koha sinkron viti 2011 (Tabela)

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit					
Raport i Drejtorisë së Programeve për Edicionet Informative					
Koha Sinkron për Subjektet Politike dhe Institucionet Qendrore (koha në %)					
Viti 2011					
Subjektet/Operatori	Top Channel	TV Klan	TVSH	Radio Tirana	Top Albania Radio
Presidenti	5.45%	1.61%	1.68%	3.71%	6.04%
Kryeministri	16.63%	29.02%	30.03%	27.49%	19.22%
Qeveria	10.37%	19.24%	22.03%	21.42%	11.25%
Parlamenti	2.71%	3.51%	4.69%	5.30%	4.05%
Partia Demokratike	10.95%	20.49%	22.73%	15.67%	12.05%
Partia Socialiste e Shqipërisë	43.07%	13.52%	9.88%	17.30%	35.88%
Lëvizja Socialiste për Integrim	3.31%	8.16%	6.68%	6.63%	4.57%
Partia Republikane	0.46%	0.56%	0.53%	0.08%	0.19%
Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut	0.55%	0.18%	0.00%	0.20%	0.52%
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	0.98%	1.03%	0.87%	0.77%	1.64%
Aleanca Demokratike	0.00%	0.24%	0.12%	0.00%	0.00%
Lëvizja Demokristiane	0.17%	0.00%	0.00%	0.00%	0.23%
Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	0.04%	0.00%	0.00%	0.00%	0.16%
Partia Agrare Ambientaliste	0.00%	0.00%	0.11%	0.00%	0.00%
Partia Bashkimi Liberal Demokrat	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%	0.00%
Partia Demokracia Sociale e Shqipërisë	0.35%	0.95%	0.02%	0.10%	0.29%

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT

Partia Demokristiane	0.05%	0.04%	0.04%	0.00%	0.08%
Partia e Ballit Kombëtar	0.07%	0.00%	0.00%	0.00%	0.21%
Partia e Ballit Kombëtar Demokrat	0.00%	0.00%	0.12%	0.07%	0.00%
Partia G99	0.20%	0.06%	0.10%	0.00%	0.06%
Partia Lëvizja e Legalitetit	0.03%	0.10%	0.08%	0.04%	0.07%
Partia për Ligj dhe Drejtësi	0.13%	0.08%	0.08%	0.05%	0.12%
Partia Socialdemokrate e Shqipërisë	3.44%	0.20%	0.04%	0.54%	1.79%
Partia Socialiste 91	0.72%	0.04%	0.00%	0.10%	0.86%
Partia Komuniste e Shqipërisë	0.05%	0.75%	0.03%	0.00%	0.00%
Partia Pensioniste	0.00%	0.16%	0.00%	0.00%	0.12%
Shuma	100%	100%	100%	100%	100%

3.3.3. Raportet kohore për temën e lajmit

Raportet kohore për temën e lajmit viti 2011

(Tabela)

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit					
Raport i Drejtorisë së Programeve për Edicionet Informative					
Koha e Plotë për Temën e Lajmit (koha në përqindje)					
Viti 2011					
Temat	Top Channel	TV Klan	TVSH	Radio Tirana	Top Albania Radio
Politikë	27.60%	29.20%	21.27%	19.08%	24.69%
Veprimtaria e Presidentit	1.16%	0.54%	1.08%	1.98%	1.17%
Veprimtari e Qeverisë	3.96%	8.06%	17.27%	13.24%	4.70%
Veprimtari e Parlamentit	2.82%	3.45%	6.79%	7.08%	4.92%
Veprimtari e Qeverisë Vendore	0.69%	3.37%	1.73%	2.84%	1.50%
Veprimtaria e Drejtësisë	5.87%	2.97%	0.94%	1.53%	3.66%
Sociale	10.26%	12.27%	19.96%	10.16%	8.01%
Ekonomi	4.95%	6.45%	5.69%	4.47%	3.18%
Kronika e Zezë / Rendi	4.37%	5.15%	2.13%	5.12%	9.14%
Lajme nga Kosova / Rajoni	10.46%	3.12%	2.65%	10.27%	14.23%
Lajme Ndërkombëtare	15.99%	8.47%	3.53%	10.08%	11.88%
Art / Kulturë / Kuriozitete	5.00%	4.69%	8.15%	4.05%	1.46%
Sport	2.84%	6.25%	5.14%	6.51%	4.99%
Të Tjera	4.04%	6.00%	3.67%	3.57%	6.49%
Shuma	100%	100%	100%	100%	100%


Siç e theksuam më sipër, vihet re se në edicionet informative kryesore të lajmeve të transmetuara operatorët radiotelevizivë gjatë vitit 2011 i kanë kushtuar më tepër kohë temës së politikës. Lajmet e para të edicionit informativ janë ato që flasin për veprimtarinë e qeverisë dhe të Kryeministrit, veprimtarinë e Presidentit, Parlamentit, Qeverisë vendore, dhe institucioneve të Drejtësisë, më pas ato me përmbajtje sociale, ekonomike, kulturore etj.

Por vlen të theksohet se është shtuar tendenca e operatorëve radiotelevizivë ndaj paraqitjes së fenomeneve të caktuara sociale, ekonomike, artit, kulturës, kuriozitetëve etj.

Si më poshtë vijon po ju paraqesim një grafik që pasqyron qëndrimin e operatorëve Top Channel, Tv Klan, TVSH, dhe Radio Tirana e Top Albania Radio ndaj fenomeneve sociale, ekonomike, kulturore, të artit, kuriozitetëve, sportit, krahasuar kjo me kohën kushtuar temës së politikës.

-Operatorët televizivë Top Channel, Tv Klan, Televizioni Shqiptar


Grafiku viti 2011



Siç shihet dhe nga grafiku, për operatorët televizivë Top Channel, Tv Klan, Televizioni Shqiptar, koha kushtuar temës së politikës zë pjesën më të madhe, krahasuar me kohën kushtuar temës sociale, ekonomike, kulturore dhe sportive.


-Operatorët radiofonikë Radio Tirana e Top Albania Radio

Grafiku, viti 2011



Siç shihet dhe nga grafiku, për operatorin radiofonik Radio Tirana, koha kushtuar temës sociale, ekonomike, kulturore e sportive së bashku është më e madhe krahasuar me kohën kushtuar temës së politikës.

Grafiku, viti 2011



Siç shihet dhe nga grafiku, për operatorin radiofonik Top Albania Radio, koha kushtuar politikës është më e madhe, krahasuar me kohën kushtuar temës sociale, ekonomike, kulturore dhe sportive.

3.3.4 Raportet kohore për aktorët “sinkron”

Koha Sinkron për Aktorët Politikë (koha në përqindje)					
AKTORI SINKRON	TVSH	TV KLAN	TOP CHANNEL	RADIO TIRANA	TOP ALBANIA RADIO
Bamir TOPI	1.44%	0.57%	5.38%	3.37%	5.66%
Sali BERISHA	36.79 %	24.07%	20.19%	29.92%	21.76%
Jozefina TOPALLI	4.77%	2.29%	1.44%	4.99%	2.46%
Edi RAMA	4.92%	3.94%	17.72%	7.09%	13.28%
Ilir META	4.25%	2.05%	2.29%	3.58%	3.39%
TË TJERË	47.84%	60.08%	52.98%	51.06%	53.46%
SHUMA	100%	100%	100%	100%	100%

3.3.5. Monitorimi i fushatës zgjedhore

Monitorimi i pasqyrimet nga media elektronike i fushatës për zgjedhjet vendore të vitit 2011 ka qenë një nga angazhimet më të rëndësishme të KKRT-së. Megjithatë pasqyrimi i fushatës zgjedhore në median elektronike rregullohet nga Kodi Zgjedhor, pjesëmarrja e Drejtorisë së Programeve ishte maksimale.

Ky proces u krye në bashkëpunim me Bordin e Monitorimit të Medias i ngritur nga KQZ-ja, i cili, në bazë të Kodit Zgjedhor, për kryerjen e monitorimit shfrytëzon kapacitetet teknike të KKRT-së. Për nevojat e monitorimit, për rregullat, mënyrën dhe afatet e shfrytëzimit të kapaciteteve tona teknike, KKRT-ja dhe KQZ-ja, gjatë muajit shkurt 2011, nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit “Për monitorimin e fushatës së zgjedhjeve për Organet e Qeverisjes Vendore të datës 08.05.2011”, e cila përcaktonte detyrimet për monitorimin e fushatës zgjedhore 2011 në radiot dhe televizionet në Republikën e Shqipërisë.

3.3.6. Mbi zbatimin e kërkesave ligjore për transmetimin e reklamave

Zbatimi i kërkesave të ligjit në transmetimin e reklamave është vlerësuar nga KKRT si një element i rëndësishëm dhe i ndjeshëm, i ekzistencës dhe funksionimit të subjekteve radiotelevizive.

Gjatë vitit 2011 është konstatuar se, në përgjithësi, nga të gjithë operatorët radiotelevizivë bëhen përpjekje për zbatimin e ligjit. Në përgjithësi janë respektuar kushte të tilla si kohëzgjatja e transmetimit të reklamave brenda një dite dhe brenda një ore transmetimi, është zbatuar kërkesa e ligjit në lidhje me format e paraqitjes së reklamave dhe kushte të tilla si detyrimi që reklammat të jenë me folës shqip apo të subtitruara në gjuhën shqipe, që ato të jenë të ndershme dhe të mos dëmtojnë të tjerët etj. Janë zbatuar dispozitat ndaluese për reklammat, të përcaktuara në nenin 55 të ligjit. Është për t'u theksuar fakti se, në median tonë elektronike, prej vitesh nuk transmetohen reklammat e produkteve të duhanit dhe asnjë program radioteleviziv nuk është sponsorizuar nga persona fizikë dhe juridikë që kanë si veprimtari kryesore të tyren, tregtimin apo prodhimin e produkteve të duhanit. Duhet vlerësuar fakti se nga operatorët radiotelevizivë janë zbatuar edhe kërkesat e ligjit në lidhje me reklamimin e pijeve alkoolike.

Në lidhje me ndërfutjen e reklamave brenda një programi apo një emisioni duhet të pranojmë se ka pasur edhe shkelje, sidomos në rastin e telenovelave dhe filmave artistikë, duke mos u respektuar intervali kohor midis dy ndërprerjeve. Vihet re gjatë transmetimeve të programeve të ndryshme dukuria e “vendosjes së produktit”, si një formë të re të transmetimit të publicitetit, e cila edhe pse nuk përfshihet në ligjin tonë aktual, aplikohet në formën e reklamave të fshehta. Me “vendosje të produktit” kuptojmë çdo formë të reklamës apo teleshitjes që konsiston në përfshirjen, referimin ose përmendjen e një produkti, shërbimi ose marke tregtare, që shfaqet brenda një programi, përkundrejt pagesës ose një shpërblimi të ngjashëm. Në parim “vendosja e produktit” është e ndaluar. Në transmetimet televizive ai është përdorur në emisionin “E Diela Shqiptare”, në emisionin “Zonë e lirë”, etj.

Vërejmë se vazhdon përfshirja e reklamave indirekte ose të tërthorta, gjatë transmetimit të edicionit të lajmeve në televizion. Ato janë aplikuar në formën e një kronike duke promovuar një biznes, një shërbim ose një produkt të ri, që bie ndesh me dispozitat ligjore në fuqi.

Po ashtu vlen të theksohet se detyrimet e parashikuara nga nenet 54 dhe 54/1 të ligjit nr. 8410 datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, “Arkivimi i reklamave” që parashikojnë se “reklammat e transmetuara ruhen të regjistruara sipas radhës së tyre për një kohë 1-vjeçare nga dita e transmetimit”, si dhe “për transmetimin e reklamave radiotelevizive, operatorët radiotelevizivë duhet të zotërojnë të drejtën e transmetimit të tyre në Shqipëri”, vazhdojnë të mos zbatohen.

IV. RRJETET E TRANSMETIMIT DHE MBULIMI ME SINJAL I ZONAVE TË LICENCIMIT

Gjatë vitit 2011 KKRT, ka vazhduar punën për konsolidimin e veprimtarisë teknike në fushat e **Planifikimit të spektrit të frekuencave, Monitorimit të shfrytëzimit** të këtij spektri dhe **Identifikimit të transmetimeve të paautorizuara**. Një punë voluminoze është kryer për përpunimin e strategjisë së kalimit në transmetimet numerike dhe mbylljen e transmetimeve televizive analoge.

4.1. PLANIFIKIMI I SPEKTRIT TË FREKUENCAVE

4.1.1. Planifikimi i rrjeteve numerike

KKRT, mbështetur në rezultatet e vitit paraardhës në planifikimin e frekuencave numerike¹, ka vazhduar punën për sigurimin e implementimit të rrjeteve numerike, kombëtare, rajonale e vendore, mbështetur në frekuencat e planifikuara e të regjistruara tashmë në Regjistrin Ndërkombëtar të Frekuencave në ITU.

Regjistrimi i caktimeve frekuencore në plan nuk është fundi i procesit të vënies në punë të caktimeve frekuencore. Për vënien e tyre në punë, në përputhje me nenin 5 të Marrëveshjes së Gjenevës të vitit 2006, duhet të kryhet procedura e notifikimit të caktimeve frekuencore, ku pika 5.1.1 e së cilës përcakton se: *“Kur një administratë propozon të sjellë në përdorim një caktim për një stacion transmetimi, ajo duhet të njoftojë (notifikojë) Byronë², në përputhje me dispozitat e nenit 11 të Radio Rregulloreve³, karakteristikat e këtij caktimi, siç specifikohen në Aneksin 3 të Marrëveshjes⁴”*.

Për kryerjen e këtij procesi është e nevojshme të merret edhe miratimi i vendeve të tjera, sidomos i vendeve që janë shënuar në një kolonë të veçantë (Kolona R-1)⁵ në Planin e miratuar nga GE-06.

4.1.2 Planifikimi i bandës FM

Administrimi i frekuencave të bandës FM, përherë ka qenë problem i vështirë, për arsye:

1. të transmetimeve që kanë ekzistuar përpara krijimit të KKRT-së dhe që përdornin frekuenca të caktuara pa u mbështetur në kritere teknike;
2. të interferencave të fuqishme të transmetimeve FM nga territori italian, të cilat nuk jepen në përputhje me Marrëveshjen GE-84, të cilën qeveria italiane nuk e ka ratifikuar.

¹ Shih Raportin Vjetor për vitin 2009, pika 4.1 Planifikimi i rrjeteve numerike

² Byroja - Byroja e Radiokomunikacioneve e Bashkimit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve (ITU)

³ Radio rregulloret – rregulloret e ITU sipas neni 31 të Statutit të ITU.

⁴ Marrëveshja- Marrëveshja GE-06

⁵ Në Kolonën R-1 jepen simbolet e ITU për administratat të cilave u preken caktimet analoge me futjen në punë të caktimit numerik.

Problemi është rënduar kohët e fundit nga plotësimi i kërkesave në rritje për licenca radio FM. Në këto kushte, me gjithë punën intensive për digjitalizimin e transmetimeve televizive, Drejtoria Teknike ka studiuar gjendjen e transmetimeve FM në zonën më të rënduar, që është ajo e Tiranës.

Hapësira e kanalit radio FM

Rekomandimi ITU-R BS. 412.7, pika 3 (Hapësira e kanaleve) përcakton se:

“Kanalet jepen në mënyrë të tillë që:

3.1 frekuencat mbartëse që përcaktojnë vendosjen nominale të kanaleve RF brenda bandës të jenë shumëfisha të plotë të 100 kHz;

3.2 për të dy llojet e transmetimeve monofonik dhe stereofonik aplikohet një hapësirë uniforme kanalesh prej 100 kHz.

Shënim: 1 Në rastet kur një hapësirë 100 kHz do të jetë e vështirë të implementohet, përdorimi i një hapësire prej shumëfishash të plotë të 100 KH do të jetë gjithashtu e pranueshme , me kusht që frekuencat mbartëse të zgjidhen në përputhje me paragrafin 3.1 më sipër”.

Rekomandimi i mësipërm është aplikuar edhe në Shqipëri gjatë planifikimit të transmetimeve radio FM për mbulimin e territorit të Republikës. Për arsye të kushteve të Shqipërisë, hapësira e kanaleve është vendosur, 300 kHz (mbështetur në shënimin 1 më sipër). Aplikimi i një standardi të tillë, duke krijuar hapësira mbrojtëse të mjaftueshme për të shmangur sidomos interferencat nga kanali fqinjë, ka ndikuar në sigurimin e një cilësie të pranueshme transmetimi edhe në kushtet e transmetimeve jashtë bande të shkaktuara nga mungesat që kanë operatorët shqiptarë (mungesa të stafit të përherëshëm teknik që sjell probleme në mirëmbajtjen preventive, etj). Nga ana tjetër aplikimi i një standardi të tillë ka ngushtuar hapësirat për rritjen e numrit të operatorëve.

Okupimi i spektrit

Problemi është i mprehtë sidomos në zonën e Tiranës, ku edhe kërkesat kanë qenë dhe mbeten të mëdha.

Aktualisht zona Tiranë-Durrës mbulohet nga sinjalet e 37 radiove në funksion (përfshirë 2 stacionet publike kombëtare). Përveç tyre, 2 frekuenca u përkasin radiove që u është hequr licenca.

Nr.	Operatori	Pika e Transmetimit	Frekuenca (MHz)	Gjendja e transmetuesit
1.	Radio New-Planet	Fushë-Dajt	89	Në transmetim
2.	Radio Stinët	Fushë-Dajt	106.9	Në transmetim

Operatorët Radio FM të cilëve u është hequr licenca dhe vazhdojnë të jenë në transmetim

Siç rezulton nga të dhënat tona i gjithë spektri për transmetime FM është i okupuar pothuaj plotësisht në zonën Tiranë –Durrës. Gjithashtu po nga të dhënat tona, janë evidentuar edhe frekuenca të veçanta, të cilat nuk mund të përdoren për shkak të ndërhyrjeve nga vendet fqinjë apo të okupimit të frekuencave në zona të tjera të Shqipërisë (Ardenicë, Tarabosh, Kodër Ishëm, etj).

Përveç sa më sipër disa frekuenca të operatorëve të veçantë, janë të ndryshme nga frekuencat e dhëna në licencë. Më poshtë jepen operatorët më problematikë:

1. Radio Nacional

Është autorizuar nga KKRT të transmetojë në frekuencat 93.4 MHz nga pika e transmetimit në Fushë Dajt. Ky subjekt ka paraqitur në KKRT ankesa për interferencë të shkaktuar ndaj sinjalit të tij.

Për të shmangur interferencat, Radio « Nacional » ka ndryshuar frekuencën e transmetimit nga 93.4 MHz në 93.6 MHz, pa autorizimin e KKRT,

Për verifikimin e këtyre ankesave Drejtoria Teknike ka organizuar matje në pika të ndryshme të qytetit të Tiranës (Godina e KKRT-së, Laprakë, Kinostudio). Nga matjet e rezultoi se në frekuencën 93.4 MHz, në zonën e mbulimit të radio « Nacional » konstatohen nivele të larta të një sinjali radio FM të ardhur nga Mali i Zi. Stacioni interferues emërtohet MOZURA dhe është i regjistruar në Regjistrin Ndërkombëtar të Frekuencave (MIFR). Ai transmeton me një ERP 40 dBW (10 kW). Regjistrimi në MIFR, bazuar në Marrëveshjen GE 84, i jep të drejtën administratës së Malit të Zi të mbrojë këtë frekuencë duke bërë të pavlefshme përpjekjet tona për ndryshimin e saj.

2. Radio Nostalgjia

Është autorizuar të transmetojë në 89.8 MHz nga pika e transmetimit të Fushë Dajtit. Subjekti ka paraqitur kërkesën për ndryshimin e frekuencës së transmetimit për shkak të ndërhyrjeve të fuqishme në zonën e bregdetit. Nga matjet rezultoi se pretendimi ishte i drejtë.

3. Radio Greta

Ka fituar garën e shpallur nga KKRT dhe është autorizuar të transmetojë në frekuencën 93.7 MHz me Vendimin nr 54, date 28.07.2010. Kjo frekuencë rezulton 100 KHz pranë frekuencës ku aktualisht transmeton pa autorizim Radio “Nacional” dhe për pasojë, mund të shkaktojë interferencë.

4. Radio Aldo 03

Ka ndërruar frekuencën pa autorizimin e KKRT-së nga 98.8 MHz në 98.7 MHz. duke iu afruar me 100 kHz frekuencës së Radio ONE (licencuar me Vendimin nr. 55, date 28.07.2010).

5. Radio Durrësi

Radio Durrësi u licencua në frekuencën 99.7 MHz nga pika e transmetimit në qytetin e Durrësit. Ndonëse kjo vendosje është brenda standardeve teknike, operatori publik (RTSH) ka kontestuar në shtator 2010, dhënien e kësaj frekuence, pasi ajo ndodhet 200 kHz larg frekuencës së stacionit transmetues të RTSH-së në malin e Dajtit.

6. Radio Albania FM

Radio Albania FM është licencuar në frekuencën 89 MHz (pika e transmetimit në Fushë Dajt). Kjo radio aktualisht transmeton në frekuencën 90.4, pasi në frekuencën 89 MHz vazhdon të transmetojë pa leje radio “New Planet” të cilës i është hequr licenca nga KKRT.

Transmetime nga pika të tjera përveç Dajtit që afektohen nga transmetimet e Dajtit:

- Radio Euro Star (Petresh)

Radio Euro Star (licencuar në frekuencën 96.6 MHz Petresh) ka ndryshuar frekuencën e transmetimit në 96.5 MHz për shkak të interferencave nga Radio Ora (96.7 MHz në Fushë Dajt).

- Propozimet për ndryshime

Me qëllim që të evitohen interferencat nga kanalet fqinjë si dhe të krijohen hapësira të lira për rritjen e numrit të transmetimeve radiofonike në zonën Tiranë-Durrës dhe në rajone të tjera, nga KKRT mendohet të merren masat e mëposhtme afatshkurtra dhe afatmesme:

1. Mbyllja e stacioneve të cilëve u është revokuar licenca

Siç pasqyrohet në Tabelën 1, me mbylljen e stacioneve të paautorizuara, që sot janë në transmetim, përfitohen dy frekuenca të lira.

2. Riorganizimi i frekuencave të zonës së Tiranës

Riorganizimi i shfrytëzimit të spektrit të zonës së Tiranës do të bëjë të mundur shmangien e interferencave nga kanalet fqinjë dhe reduktimin e interferencave të shkaktuara nga transmetime jashtë kufijve të vendit, duke lejuar një shfrytëzim më efektiv të brezit të disponueshëm.

3. Kalimi në hapësirën 200 kHz

Realizimi i këtij kalimi, do të rrisë në maksimum efektivitetin e shfrytëzimit të frekuencave, por kërkon një planifikim të kujdesshëm dhe një zbatim rigoroz. Ai duhet të kryhet në konsultim të gjerë me operatorët (sidomos me operatorin publik) dhe institucionet e tjera të interesuara.

Paraprakisht, duhet vlerësuar gjendja e stacioneve transmetues të operatorëve radio shqiptarë, duke matur karakteristikat e transmetimit të secilit prej tyre, për të verifikuar nëse sinjali i emetuar gjendet konform standardeve teknike. Pas përfundimit të matjeve do të hartohet një Raport Teknik ku të jepet edhe propozimi përkatës së bashku me projekt Planin e ri të frekuencave për të gjithë territorin e Shqipërisë. Duke pasur parasysh faktin se shumë operatorë kishin filluar transmetimet përpara krijimit të KKRT-së dhe për pasojë frekuencat e okupuara prej tyre nuk korrespondojnë me Planin e frekuencave për Shqipërinë në përputhje me marrëveshjen GE 84, gjatë punës për hartimin e planit të ri të frekuencave do të synohet edhe harmonizimi me planin GE 84.

Implementimi i këtij plani mund të fillojë me licencimet e reja në plotësim të kërkesave që do të paraqiten pas miratimit të planit të ri.

4.1.3. Shfrytëzimi i dividendit digjital për shërbime të tjera të telekomunikacioneve.

Dividendi numerik (ose digjital) konsiderohet si një mundësi unike për të plotësuar kërkesën në rritje të shpejtë për shërbimet e komunikimit pa tel. Ai hap një spektër të mjaftueshëm për transmetuesit për të zgjeruar e zhvilluar në mënyrë të

konsiderueshme shërbimet e tyre, duke siguruar në të njëjtën kohë përdorime të tjera të rëndësishme sociale e ekonomike, si aplikimet me bandë të gjerë për të cilat edhe në Shqipëri po përgatitet strategjia përkatëse.

Siç përmendet edhe në Raportin e vitit të kaluar⁶ në Shqipëri, në brezin e parashikuar për Dividendin Numerik (Digital), aktualisht ka transmetime analoge, transmetime ekzistuese numerike dhe kanale të planifikuara për transmetime numerike sipas Planit GE 06. Për të mos pakësuar kapacitetet transmetuese të fituara nga Plani GE 06, rezulton i nevojshëm riplanifikimi i transmetimeve numerike në breza më të ulët frekuencash. Por për të realizuar këtë duhet ndërmarrë një proces i vështirë e i komplikuar koordinimi me vendet fqinje (brenda rrezes prej 1000 km që është distanca e koordinimit) për të regjistruar në planin e GE 06 të rreth 13 % të caktimeve frekuencore totale të planifikuara.

Duke marrë në konsideratë vështirësitë e procesit të koordinimit, i cili mund të rezultojë pa rezultat, si pasojë e interesave të të gjitha vendeve për të shfrytëzuar në interes të vet të gjitha burimet e fundme, shumë vende kanë vendosur të mos bëjnë më riplanifikim, por thjesht të reduktojnë mbulimet e planifikuara. Në rastin e Shqipërisë kjo do të sillte mos shfrytëzimin e të paktën 1 mbulimi (nga 7+1 mbulime do të mbeten 6+1 mbulime).

Aplikimi i një strategjie të tillë nuk e përjashton procesin e riplanifikimit dhe koordinimit me vendet fqinje në një kohë të mëvonshme.

4.1.4. Planifikimi i rrjeteve analoge

4.1.4.1. Planifikimi ndërkombëtar i frekuencave

Më 19 Maj 2011, në selinë e ITU u zhvillua një mbledhje e kërkuar nga disa vende si Kroacia, Sllovenia, etj. për të diskutuar problemin e interferencave në transmetimet FM të disa vendeve të shkaktuara nga stacione italiane të vënë në punë pa përfillur procedurat e përcaktuara nga marrëveshja GE – 84. Gjatë serisë së diskutimeve rreth tryezës të gjitha administratat, përfshirë edhe përfaqësuesit e KKRT-së, shprehën pikëpamjet e tyre lidhur me gjendjen e interferencave.

Në ndjekje të problemit, ITU, në datat 31 tetor- 4 nëntor 2011, organizoi mbledhjen e Bordit të Radio Rregulloreve (RRB) ku u diskutua serish problemi i interferencave të dëmshme midis Italisë dhe vendeve fqinje.

4.1.4.2. Puna për planifikimin e frekuencave analoge (radio e tv), për licencimin e operatorëve të rinj dhe përmirësimin e mbulimit të operatorëve analogë ekzistues.

Edhe për vitin 2011, KKRT ka organizuar studimin e shfrytëzimit të spektrit të frekuencave si për TV dhe radio FM, për përcaktimin e frekuencave të lira për shpalljen e konkurrimit të kandidaturave, në përgjigje të kërkesave nga zona të ndryshme të vendit. Për këtë janë bërë llogaritje për mbulimin e zonave të licencimit si dhe llogaritje për eliminimin e interferencave me sinjalet e tjera radio dhe televizive.

⁶ Shih Raporti Vjetor 2010, pika 4.1.2 “Shfrytëzimi i dividendit digital për shërbime të tjera të telekomunikacioneve”

Pas llogaritjeve në tavolinë, ka qenë e nevojshme edhe kryerja e matjeve në terren për shfrytëzimin e spektrit dhe zhurmat e ndryshme, konsultimi me data base-t e ITU-s për transmetimet në vendet fqinjë etj. Nga kontrollet dhe matjet është konstatuar se shfrytëzimi i spektrit në Shqipëri vazhdon të rëndohet, sidomos në zonat me interes të lartë (ultësira perëndimore deri në Sarandë, zona e Korçës, etj) ndërsa nuk ka interes për mbulimin e zonave të largëta (Peshkopi, B. Curri, Ersekë).

Gjithsej, gjatë vitit 2011, është përgatitur dokumentacioni teknik për 10 caktime frekuencore për transmetime televizive vendore private (2 licenca të reja dhe 5 zgjerime) dhe 35 caktime frekuencore për transmetime vendore private radio FM (shih tabelat 1 dhe 2 më poshtë).

Pas zbatimit të procedurave të garave, gjatë vitit 2011, janë licencuar 2 operatorë të rinj vendorë privatë televizivë: TV BEST (Librazhd) (1 caktim frekuencor) dhe TV ADRIA MED (1 caktim frekuencor).

Gjithashtu janë licencuar 10 operatorë vendorë privatë radio duke planifikuar gjithsej 35 caktime frekuencore në pika të ndryshme transmetimi.

Pas zhvillimit të konkurrimit të kandidaturave për licencë për televizion analog në qarqet Elbasan dhe Korçë, TV UFO fitoi të drejtën të zgjerojë zonën e licencimit edhe në këto dy qarqe. Për këtë, këtij subjekti i janë shtuar 6 caktime frekuencore për mbulimin me sinjal të Qarkut Elbasan dhe Qarkut Korçë.

Bazuar në ligjin nr. 8410, datë 30.09.1998 “ Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, (neni 34, pika 4) *operatori duhet të fillojë transmetimin pas hyrjes në fuqi të vendimit për dhënie licence për një periudhë kohe 180 ditë në transmetimet e radio vendore dhe 270 ditë në transmetimet e televizionit vendor.*

Në tabelat e mëposhtme (Tab.1, Tab.2, Tab.3 dhe Tab.4) janë paraqitur operatorët e licencuar në vitin 2011 dhe gjendja e tyre faktike e transmetimit.

Tab. 1. Operatorë të rinj të licencuar për TV vendorë

Nr	Emri	Pika e transmetimit	Data e licencimit	Afati i fundit i daljes në transmetim	Zona e licencimit	Gjendja reale e transmetuesit
1	TV BEST	Librazhd	03.10.2011	03.08.2012	Qarku Elbasan	(Brenda afatit ligjor)
2	TV ADRIA MED	Kodra e Marinës	03.10.2011	03.08.2012	Rrethi Durrës	(Brenda afatit ligjor)

Tab. 2 Operatorët radiofonikë të licencuar në vitin 2011

Nr	Emri	Pika e transmetimit	Data e licencimit	Afati i fundit i daljes në transmetim	Zona e licencimit	Gjendja reale e transmetuesit
----	------	---------------------	-------------------	---------------------------------------	-------------------	-------------------------------

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT

		etimit		transmetim	mit	
1	Radio Durrësi	Durrës (Kodër) Krujë	20.12.2010	18.06.2011	Qarku Durrës	Nuk është verifikuar
2	Radio Epiri	Kërcullë	28.03.2011	24.09.2011	Rrethi Gjirokastrë	Nuk është verifikuar
3	Radio ABC	Dajt Fier (Qytet) Zvërnec Llogara Treblovë Tërbaç Mile	28.03.2011	24.09.2011	Rrethet Tiranë Durrës Fier Vlorë	Nuk është në transmetim
4	Radio Dimensio n	Tarabosh	30.06.2011	27.12.2011	Rrethi Shkodër	Nuk është verifikuar
5	Radio Hit FM	Petresh	30.06.2011	27.12.2011	Rrethi Elbasan	Në transmetim
6	Radio Univers	Fushë-Dajt Ardenicë Zvërnec Llogara Treblovë Tërbaç Mile	30.06.2011	27.12.2011	Qarqet Tiranë Durrës Fier Vlorë	Në transmetim (Tiranë)
7	Radio Number 1	Fushë-Dajt Ardenicë Zvërnec Llogara Treblovë Tërbaç Mile	30.06.2011	27.12.2011	Qarqet Tiranë Durrës Fier Vlorë	Nuk është në transmetim
8	Radio Clazz	Fushë-Dajt Ardenicë Zvërnec Llogara Treblovë Tërbaç Mile	25.07.2011	21.01.2012	Qarqet Tiranë Durrës Fier Vlorë	Nuk është në transmetim
9	Radio City Albania	Fushë-Dajt	25.07.2011	21.01.2012	Rrethet Tiranë Durrës	Në transmetim

10	Radio Sprint	Kërcullë	30.06.2011	27.12.2011	Rrethi Gjirokastrë	Nuk është verifikuar
----	--------------	----------	------------	------------	--------------------	----------------------

Tab. 3 Operatorët televizivë që kanë zgjeruar zonën e licencimit në vitin 2011

Nr	Emri	Pikat ekzistuese të transmetimit	Data e vendimit për zgjerim zone	Pika e re e transmetimit	Zgjerimi i zonës së mbulimit	Gjendja reale e transmetuesve në pikat e reja
1	TV “UFO EDUCATION”)	Fushë Dajt Durrës	30.11.11	1. Petresh 2. Librazhd 3. Gramsh 4. Çervenakë 5. Çardhak 6. Erseke	Qarqet Elbasan-Korçë	Nuk është verifikuar

Tab. 4 Operatorët radio që kanë zgjeruar zonën e licencimit në vitin 2011

Nr .	Emri	Pikat e Transmetimit ekzistuese	Data e vendimit për zgjerim zone	Pika e re e transmetimit	Zgjerimi i zonës së mbulimit	Gjendja reale e transmetuesve në pikat e reja
1	Radio Albania FM	Petresh	25.07.2011	Fushë-Dajt	Rrethet Tiranë - Durrës	Në transmetim

Në vitin 2011 është përgatitur Lidhja III dhe Lidhja IV e dokumentit të licencës⁷ për 35 operatorë radiotelevizive, nga të cilët 11 operatorë radio vendore, 3 operatorë televizivë vendorë dhe 21 televizione kabllorë të licencuar gjatë vitit 2011.

4.2. MONITORIMI I SHFRYTËZIMIT TË SPEKTRIT TË FREKUENCAVE

Bazuar në eksperiencën e fituar në vite, edhe gjatë vitit 2011, KKRT ka ndjekur transmetimet radio e televizive, me qëllim identifikimin e lokalizimin e transmetimeve të paautorizuara.

Krahas inspektimit të planifikuar, për sinjalet radio e televizive që mund të kapen nga Tirana (kryesisht për sinjalet që mbulojnë hapësirën Tiranë-Durrës), është

⁷ Lidhja III dhe lidhja IV e dokumentit të licencës janë specifikimet dhe karakteristikat teknike të pajisjeve transmetuese.

organizuar monitorimi ditor, që regjistron gjendjen e transmetimeve radiotelevizive, e cila raportohet në fund të çdo jave.

Evidentimi i saktë dhe ndjekja e përditshme ka bërë që të mbahet nën kontroll regjimi i transmetimeve, sidomos në zonën e rënduar Tiranë-Durrës, ku me të konstatuar një anomali, është ndërhyrë menjëherë për të stabilizuar situatën.

4.2.3. Operatorë që u është hequr licenca për ndërprerje transmetimi

Me Vendimin nr. 83, datë 25.02.2011 – i ndryshuar, të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit subjektit “Tele 1” i është hequr licenca për shkelje të dispozitave të pikës 5 të nenit 34 të ligjit “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, sipas te cilit: *“Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ka të drejtë të heqë licencën e transmetimit kur: ... 5. pas fillimit të transmetimit, gjatë një viti kalendarik, nuk transmetohet 30 ditë, pa llogaritur ndërprerjet për arsye teknike që nuk varen nga mbajtësi i licencës”*.

Prej datës 29. 12. 200 në kanalën 68 UHF që më parë i përkiste këtij subjekti, ka dalë në transmetim një subjekt me logo CHANNEL 1, i paautorizuar nga KKRT-ja. Mbyllja e këtyre transmetimeve është ndaluar përkohësisht nga gjykata për shkak të zhvillimit të një procesi gjyqësor ndërmjet TELE 1 dhe KKRT-së.

4.2.4. Operatorë radiofonikë privatë vendorë që kanë pasur ndërprerje të shpeshta të transmetimit.

Nga monitorimi në terren apo monitorimi ditor i kryer nga qendra fikse e monitorimit të frekuencave në KKRT, në periudha të ndryshme të vitit 2011, rezulton se këtë vit operatorët i kanë kushtuar kujdes më të madh gatishmërisë teknike të pajisjeve transmetuese.

Për disa operatorë, problem ka qenë furnizimi jo i rregullt me energji elektrike që ka shkaktuar ndërprerje të shpeshta si dhe avari serioze në disa pajisje transmetuese, që i kanë detyruar të kryejnë shpenzime suplementare. Kështu Alpo TV raporton se brenda vitit 2011 ka nderuar dy herë pajisjen transmetuese të televizionit dhe një herë të radios. Ndërprerje të shpeshta të energjisë elektrike raporton edhe operatori “Elrodi Music”, “News 24”, Radio “Dimension” Radio “Fieri”, Radio “Jug”, Tv “Koha”, Tv “Preza”, Radio “Sport” Radio “Kiss”, TV BBF dhe Radio “Dinamic Sound”.

Radio “Ngjallja” raporton për ndërprerje të shpeshta të energjisë, sidomos në pikën e transmetimit në malin e Dajtit.

Me gjithë vështirësitë në furnizimin me energji elektrike, disa operatorë kanë siguruar transmetim thuajse të pandërprerë nëpërmjet përdorimit të motor-gjeneratorëve dhe baterive, gjë që ka rritur shpenzimet (Alpo TV, Elrodi Music).

4.3. TRANSMETIMET TË PALICENCUARA (SHFRYTËZIM I PAAUTORIZUAR I SPEKTRIT)

4.3.1. Transmetimet e “Vizion+”

Siç është raportuar edhe vitet paraardhës, licenca si operator televiziv vendor për subjektin “TV Vizion+” është bërë e pavlefshme pas kërkesës së vetë subjektit.

Me marrjen e licencës satelitore subjekti ka depozituar kërkesën për të ritransmetuar programin e tij edhe në rrugë tokësore, por KKRT nuk është shprehur për këtë kërkesë. **Aktualisht subjekti “TV Vizion+” vazhdon të transmetojë në të gjithë zonën ku më parë ka operuar si operator vendor si dhe në disa zona të tjera** (shih figurën më poshtë).



Fig. Mbulimi me sinjal analog tokësor i TV Vizion+

4.3.2. Transmetimet e Klan TV

Pas miratimit të kërkesës për **ndryshimin e caktimit frekuencor në pikën e transmetimit të Fushë Dajtit**, nga kanali 28 UHF në kanalin 30 UHF⁸ TV “KLAN” vazhdon të transmetojë pa leje në kanalin 41 UHF (Fushë Dajt):


Siç është theksuar edhe më parë ky kanal bën pjese në planin numerik të Shqipërisë (iteracioni IV).

4.3.3. Transmetimet TV ABC News

Operatori ABC News transmeton pa autorizimin e KKRT-së nga pikat Tarabosh në Ch 34 UHF, Korçë në Ch 23 UHF dhe në Zvërnec⁹ Ch 34 UHF. Shtrirja e mbulimit të ABC News jepet në figurën më poshtë:

⁸ Shih Raportin Vjetor 2010

⁹ Shtuar gjatë vitit 2011



4.3.4. Operatori televiziv vendor TV JUG

Ky operator ka ndryshuar pa autorizimin e KKRT-së pikën e transmetimit nga qendra e qytetit Fier në pikën transmetuese Ardenicë dhe, pavarësisht ndëshkimit me gjobë, ky subjekt nuk ka reflektuar.

4.3.5. Transmetim sinjali televiziv analog i palicencuar (Channel 1)

Prej datës 29.12.2010, në kanalin 68 UHF nga pika e transmetimit e Fushë-Dajtit, që më parë i perkiste subjektit TELE 1, ka dalë në transmetim një subjekt me logo CHANNEL one, i paautorizuar nga KKRT, por subjekti është lejuar perkohësisht nga gjykata të transmetojë, për shkak se çështja është objekt i shqyrtimit gjyqësor.

4.3.6. Transmetimet e “Real TV”.

Operatorit “Real” TV i është hequr licenca me Vendimin nr. 515/1 datë 09.10.2006 të KKRT-së. Këtij subjekti i është dërguar edhe urdhri i mbylljes së transmetimeve (nr. 177, datë 22.04.2011), por megjithatë ai vazhdon transmetimet.

4.3.7. Rritje e paautorizuar e fuqisë së transmetimit

Nga pika e transmetimit në Dajt, pothuaj të gjitha stacionet nuk respektojnë nivelet e Fuqisë Efektive të Rrezatuar (ERP) të caktuar nga KKRT. Një gjendje e tillë, përveç rritjes së panevojshme të energjisë së shpenzuar, ndikon në rritjen e nivelit të zhurmave në rajonin Tiranë – Durrës.

Me ndërhyrjet e saj, KKRT është përpjekur t’i mbajë interferencat në nivel minimal. Ndërhyrjet janë realizuar në formën e bashkëpunimit me operatorët për mbajtjen e një niveli cilësor të pranuar. KKRT, tashmë është në gjendje të matë dhe regjistrojë vlerat e sakta të fuqisë efektive të rrezatuar nga çdo transmetues.


4.3.7.1. Transmetimet e TV Elrodi Music, Vorë


Me gjithë reduktimin e fuqisë së transmetimit të ndërmarrë pas mbledhjes së Këshillit për shqyrtimin e gjobës për këtë subjekt, sinjali i tij akoma identifikohet nga qendra e monitorimit në KKRT, ndonëse me nivel më të ulët (28 -39 dμV me antenë të drejtuar nga Vora). Duke qenë se antenat marrëse janë të drejtuara nga Dajti, niveli i marrjes nga publiku ulet më tej.

Ky operator është licencuar si subjekt televiziv privat vendor, për transmetime televizive analoge tokësore, me zonë licencimi vetëm Bashkinë Vorë.

4.3.7.2. Interferenca ndaj shërbimeve të tjera shkaktuar nga operatorë radiotelevizivë

Gjatë vitit 2011, nga institucione të ndryshëm, brenda e jashtë vendit, janë paraqitur ankesa për interference të shkaktuara nga stacione të operatorëve radio shqiptarë në shërbimet e komunikimit aeronautik të autoriteteve shqiptarë e të huaj (Itali, Maqedoni). Nga inspektimet e ushtruara nga Drejtoria Teknike në bashkëpunim me AKEP ka rezultuar se disa nga stacionet e instaluar nga operatorë shqiptarë (Top Albania Radio në Cervenake, Radio Emanuel (Cardak), Radio “Stinët” (Dajt), Radio “Scan” (Dajt), Radio “Vesa” (Dajt) transmetonin jashtë standardeve teknike duke shqetësuar transmetimet e radionavigacionit aeronautik. Për ilustrim, figurat më poshtë paraqesin matjet e kryera në Rinas dhe Kodër Prezë, ku evidentohet ndërhyrja e sinjalit të Radio “Stinët” në sinjalin e shërbimit aeronautik të Rinasit:





Shkaqet e interferencës, që ndodhte kryesisht në periudhën e verës, në kushtet optimale të përhapjes së valëve, vijnë kryesisht nga mosrespektimi i parametrave të maskës spektrale të përcaktuara nga Rekomandimi ITU-R BS.412. Prandaj, operatorët u njoftuan për interferencën që shkaktonin dhe iu kërkua të sillnin menjëherë në normë parametrat e maskës, duke iu dërguar njëkohësisht edhe udhëzimin se si të realizonin matjen e parametrave të pasqyruar në Rekomandimin ITU-R SM.1268-2 (metoda e matjes së devijimit maksimal të emisioneve të transmetimit FM në stacionet e monitorimit).

Në përgjigje të kërkesave të KKRT, Top Albania Radio, Radio Scan, etj konfirmuan kryerjen e matjeve dhe sjelljen e transmetimeve brenda standardeve. Problem mbeten transmetimet e Radio “Stinet” që megjithëse nuk disponon licencë operimi, vazhdon të transmetojë jashtë parametrave teknikë. Respektimi i parametrave të maskës do të vazhdojë të jetë objekt kontrolli për vitin 2012.

4.3.8. Rrjete kabllore të palicencuar

Siç raportohet në Raportin për vitin 2010¹⁰ një numër operatorësh kabllorë (zona e Fierit, Berati, Vlorë, Korçë dhe Sarandë (Ksamil), operonin pa licencë të lëshuar nga KKRT. Gjatë vitit 2011, Drejtoria Teknike, në mbështetje të Drejtorisë Juridike dhe të Licencave bashkëpunoi për sjelljen e tyre brenda kuadrit ligjor,

¹⁰ Shih Raporti Vjetor 2010 pika 4.3.8

duke marrë pjesë në përpilimin e urdhrave për mbylljen e operatorëve të palicencuar dhe në organizimin e procedurave të licencimit, konform ligjit.

Por fenomeni i ngritjes së rrjeteve kabllorë pa marrë licencën përkatëse është konstatuar edhe në vitin 2011 në qarqet Dibër dhe Lezhë. Për këta operatorë televizivë të palicencuar, janë mbajtur proces-verbale për bllokimin apo sekuestrimin e pajisjeve të tyre. Mbështetur në këto proces-verbale, KKRT ka marrë edhe vendimet përkatëse, të cilat i janë përcjellë Drejtorive Rajonale të Tatimeve për ekzekutim.

4.3.9. Transmetime numerike të paautorizuara në kanalet e licencuara si analoge

KKRT ka autorizuar “Tring” TV për transmetime numerike tokësore për një periudhë 6 mujore, afat i cili ka përfunduar.

“Tring” vazhdon të transmetojë pa licencë në kanalet 59 UHF dhe 47 UHF. Kanali 47 UHF është licencuar nga KKRT për transmetimin e programeve analoge tokësore të subjektit TV Dardan, të cilit nuk i është rinovuar licenca. Ky kanal nuk bën pjesë në Planin e frekuencave numerike të Shqipërisë.

4.3.10. Transmetimet numerike të paautorizuara

Gjatë vitit 2011, nga monitorimi në terren, KKRT ka konstatuar se disa subjekte, të identifikuar qysh në vitin 2010, vazhdojnë të transmetojnë pa autorizimin e KKRT-së:

1. Transmetime numerike të paautorizuara në kanalet 21 dhe 66 të brezit UHF, në Malin e Dajtit, nga ALSAT.
2. Transmetime numerike në qytetin e Sarandës në kanalet 24, 32 dhe 46 të brezit UHF, pa autorizimin e KKRT-së. KKRT ka lëshuar Urdhrin e bllokimit të pajisjeve (Urdhri nr. 229, datë 14.09.2010 “Për mbylljen dhe vulosjen e pajisjeve të TV Dixhital Numerik Tokësor, Saranda, të palicencuar në qytetin e Sarandës”), i cili nuk është ekzekutuar ende nga Drejtoria e Tatimeve.
3. Transmetime numerike në qytetin e Peshkopisë në kanalet 40, 43, 44 dhe 47 të brezit UHF, pa autorizimin e KKRT-së.
4. Transmetime numerike të pa autorizuara të operatorit Digitalb në rrethin e Korçës në kanalet 62, 64, 67 dhe 69.

KKRT ka marrë masa konkrete dhe po punon intensivisht për zgjidhjen e gjithë problemeve të sipërpërmendura.

4.4. OPERATORËT

4.4.1. Operatorët radio e televizivë që mbështeten në rrjete tokësore analoge

4.4.1.1. Televizioni publik

Gjatë vitit 2011, RTSH ka vazhduar kryerjen e transmetimeve në të gjithë rrjetin e vet të transmetuesve UHF, VHF dhe të përsëritësave.

RTSH ka në funksionim 36 transmetues VHF, 29 transmetues UHF dhe një rrjet sekondar prej 210 përsëritësash.

Kombinimi i mbulimeve të realizuar nga transmetuesit që emetojnë sinjal në VHF, transmetuesit e rrjetit primat në UHF dhe përsëritësave, bëjnë që mbulimi me sinjalin e RTSH të territorit të Republikës të arrijë në mbi 92 %.

Problemet kryesore janë bashkërendimi i punës me organet e pushtetit lokal për mirëmbajtjen e përsëritësave (mungesë godinash, linjash elektrike dhe pagesa kujdestarësh), si dhe investimet e pakta në drejtim të zgjerimit dhe fuqizimit të rrjetit të transmetuesve.


RTSH ka krijuar edhe TVSH 2 (i cili mbulon vetëm zonën Tiranë-Durrës, ndërsa sipas neneve 70 dhe 71 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar: “... *duhet të mbulojë territorin e banuar nga të paktën 90% e shtetasve të Republikës së Shqipërisë*”. RTSH duhet të intensifikojë punën që, në kuadrin e implementimit të Strategjisë së Kalimit në Transmetimet Numerike, që pritet të miratohet së shpejti, të realizojë brenda vitit 2012 rrjetin numerik që do të mbulojë të paktën Ultësirën Perëndimore.

Sipas ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998, i ndryshuar, të gjitha frekuencat që kanë qenë përdorim të RTSH-së, në çastin e hyrjes në fuqi të ligjit (pa shtator 1998), mbeteshin në dispozicion të këtij institucioni për një periudhë 10-vjeçare. Në ligj nuk ekzistojnë indikacione të tjera për rregullimin e mëtejshëm dhe rrjedhimisht që prej shtator 2008 këto frekuenca duhet të rishiheshin.


KKRT, në bashkëpunim me RTSH-në, ka identifikuar të gjitha stacionet transmetuese sipas listave dhe hartave të mëposhtme, që nuk shkaktjnë interferenca mbi operatorët e tjerë dhe këto stacione janë futur në llogaritjet e mbulimit të realizuar nga RTSH për vitin 2011. Këto stacione do të jenë në funksionim deri në vitin 2015 dhe do të mbyllën në kuadrin e kalimit në transmetimeve analoge.

Figurat e mëposhtme (Fig. 5 dhe 6) pasqyrojnë mbulimin e territorit shqiptar me sinjalin e TVSH-së.

Pikat transmetuese te TVSH-se ne brezin VHF deri ne fund te vitit 2011



Pikat transmetuese te TVSH-se ne brezin UHF deri ne fund te vitit 2011



Pikat transmetuese te TVSH-se ne brezin VHF deri ne fund te vitit 2011




Fig. 5 Mbulimi me sinjal analog tokësor në bandën VHF, i realizuar nga TVSH

Mbulimi i TVSH-se ne brezin UHF deri ne fund te vitit 2011




Fig. 6 Mbulimi me sinjal analog tokësor në bandën UHF, i realizuar nga TVSH
Mbulimi 75 %

4.4.1.2. Operatorët privatë kombëtarë

Tabela e mëposhtme paraqet ecurinë në vite të zgjerimit të mbulimit të territorit të Republikës me sinjale të operatorëve kombëtarë radio e televizive, krahasuar me detyrimet për mbulim të vendosura në kushtet e licencës së secilit prej tyre.

Vitet	Emërtimi	TVSH	Radio Tirana	TV Klan	Radio Top Albania	Radio +2	TV Top Channel
		Publik	Publik	Viti lic. 2001	Viti lic. 2001	Viti lic. 2002	Viti lic. 2008
2002	Viti i lic. apo rilic.	----	----	2	2	----	----
	Kushtet e licencës	----	-----	7.33	28.85	----	----
	Mbulimi faktik %	73.31	80.54	40.91	87.22	-----	----
2003	Viti i lic. apo rilic.	----	-----	3	3	1	----
	Kushtet e licencës	----	-----	26.4	55.76	10.11	----
	Mbulimi faktik %	73.31	80.54	42.68	87.22	72.64	----
2004	Viti i lic. apo rilic.	-----	-----	4	4	2	
	Kushtet e licencës	----	-----	46.97	72.69	28.87	----
	Mbulimi faktik %	73.31	80.54	42.68	87.22	72.64	----
2005	Viti i lic. apo rilic.	----	-----	5	5	3	
	Kushtet e licencës	----	-----	62.09	94.4	55.76	----
	Mbulimi faktik %	73.31	80.54	42.68	87.22	72.64	----
2006	Viti i lic. apo rilic.	----	-----	6	6	4	
	Kushtet e licencës	----	-----	75.71	90	72.68	----
	Mbulimi faktik %	73.31	80.54	44.53	87.22	72.64	----
2007	Viti i lic. apo rilic.	----	-----	7	0	5	----
	Kushtet e licencës	----	-----	86.86	90	94.4	----
	Mbulimi faktik %	73.31	80.54	44.53	87.22	72.64	----

2008	Viti i lic. apo rilic.	----	-----	8	1	0	1
	Kushtet e licencës	----	-----	90	90	90	50
	Mbulimi faktik %	73.31	80.54	69.8	87.22	72.64	62.1
2009	Viti i lic. apo rilic.	----	-----	1	2	1	2
	Kushtet e licencës	----	-----	90	90	90	50
	Mbulimi faktik %	73.31	80.54	70.2	87.22	72.64	62.1
2010	Viti i lic. apo rilic.	----	-----	2	3	2	3
	Kushtet e licencës	-----	-----	90	90	90	90
	Mbulimi faktik %	73.31	80.54	70.2	87.22	72.64	62.1
2011	Viti i lic. apo rilic.	-----	-----	3	4	3	4
	Kushtet e licencës	-----	-----	90	90	90	90
	Mbulimi faktik %	75	80.54	78	87.22 93.7	72.64	79.4

Tab.3 Zgjerimi i mbulimit të territorit të Republikës me sinjale të operatorëve kombëtarë radio e televizivë

Llogaritjet e mbulimit janë kryer, duke marrë si nivel marrjeje nivelin 60 dB ($\mu\text{V/m}$) për sinjalin TV dhe nivelin 50 dB ($\mu\text{V/m}$) për sinjalin radio.

Operatori kombëtar Radio+2 raporton se, gjatë vitit 2011, ka pasur probleme në sigurimin e transmetimeve sistematike në zonat e Kukësit, Tropojës, Pukës, Sarandës dhe Gjirokastrës sepse pajisjet transmetuese të vendosura në kullat e RTSH-së dhe furnizuar me energji po nga RTSH-ja, respektivisht në Midë, Llogora dhe Mile nuk kanë funksionuar normalisht për shkak të mosmarrëveshjeve me RTSH-në.

4.4.1.2.1. Operatori Kombëtar TV KLAN

Operatori Kombëtar TV KLAN mbulon 78 % të territorit të Republikës së Shqipërisë me sinjal të vazhdueshëm e me cilësi. Ky operator ka vendosur stacione transmetues në 33 pika që mbulojnë gjithë territorin shqiptar. Gjatë vitit 2011 është instaluar një numër përsëritësash të rinj në pikat sekondare të rrjetit.

TV Klan transmeton nga studio fikse në qytetet e Shkodrës, Durrësit, Korçës, Elbasanit dhe Vlorës.

Programi i operatorit “Klan”, duke u mbështetur edhe në platformë satelitore si dhe në rrjetin numerik tokësor të “Digitalb”-it mund të konsiderohet se mbulon gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.






Fig.7 Pikat e transmetimit të TV KLAN sipas licencës

Pikat transmetuese teTV Klan deri ne fund te vitit 2011





Viti 2011 për Top Channel ishte viti IV i licencimit. Gjatë këtij viti operatori

mbulimit janë kryer, duke marrë nivel marrjeje 60 - 70 dB μ (V/m), më saktë 67 dB μ (V/m).

Kështu % e mbulimit të territorit të Republikës nga TV Top Channel në fund të vitit të IV të licencimit nga 62 % që është raportuar në raportin vjetor të vitit 2010, nga rillogaritjet rezulton këtë vit në 79.4 % .

Instalimi i stacioneve transmetues shtesë në pika të reja, sipas planit që përmban licenca ka përmirësuar ndjeshëm mbulimin me sinjal të realizuar nga ky operator. Figura e mëposhtme pasqyron ndryshimet në numrin e pikave transmetuese në funksionim. Më poshtë jepen të dhënat për pikat e transmetimit dhe mbulimin e realizuar nëpërmjet rrjetit analog tokësor të TV “Top Channel”.

Sipas licencës në vitin V (2012) operatori duhet të mbulojë me sinjal rrethet Has, Bulqizë, Pukë dhe Tropojë.

Programi i operatorit “Top Channel”, duke u mbështetur edhe në platformë satelitore si dhe në rrjetin numerik tokësor të “Digitalb”-it mund të konsiderohet se mbulon gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Pikat e transmetimit të TV “Top Channel” deri ne fund te vitit 2011




Fig. 9 Pikat e transmetimit të TV TOP CHANNEL në fund të vitit 2011




Fig.10 Mbulimi me sinjal analog tokësor i TV TOP CHANNEL në fund të vitit 2011

4.4.1.3. Operatorët privatë vendorë

Edhe gjatë vitit 2011 peizazhi audiovizual në Shqipëri u plotësua me operatorë të rinj radio (FM) dhe televizivë tokësorë të teknologjisë analoge.

Gjatë vitit 2011 nuk ka pasur operatorë vendorë që kanë raportuar për investime, për përmirësimin e mbulimit me sinjal të zonës së tyre të licencimit, por ka pasur nga ata operatorë radio, që e kanë zgjeruar aktivitetin në zona të reja me vazhdimësi gjeografike si më poshtë:

- Albania FM përveç rrethit të Elbasanit ka zgjeruar zonën e licencimit edhe në zonën Tiranë-Durrës (Vendimi nr. 222 datë 25.07 2011).
- TV UFO Education, që mbulonte zonën Tiranë-Durrës, ka zgjeruar zonën e licencimit edhe në qarqet Elbasan dhe Korçë.

Mbulimi i realizuar nga operatorët radio e televizivë në zonën e tyre të licencimit jepet nga hartat bashkëngjitur.

Operatorë televizivë, që rezultojnë me mbulim më të ulët të zonës së licencimit vazhdojnë të jenë:

- TV Berati 14.72 %
- TV Bajram Curri 15.2 %

Operatorët që mbulojnë deri në 70 %:

- Tirana TV 42.53 %
- Supersonic 61.24 %

Televizione me mbulim të mirë:

- TV me zonë licencimi të vogël (TV 4+, Klaudiana, etj)

Në transmetimet radiofonike, për vetë karakteristikat e brezit FM (88.5 – 104 MHz) situata paraqitet e pandryshuar, me përjashtim të licencimit të disa operatorëve të rinj.

Gjatë vitit që kaloi, disa televizione vendorë kanë kryer investime në përmirësimin e pajisjeve transmetuese dhe të studiove, për të rritur cilësinë e programeve që iu ofrohen shikuesve. Kështu “Alpo TV” informon se janë instaluar pajisje të reja në studio duke ndërtuar regjinë e re në formatin SDI.

Planet TV njofton për rindërtimin e studiove në të cilat janë instaluar pajisje digjitale. Sistemi i sinjalit audio/video është SDI.

TV News 24 raporton për ndryshimin e transmetuesit në pikën e transmetimit në Fushë Dajt.

Kukës TV raporton se ka hasur probleme me RTSh-në për rinovimin e kontratës së përdorimit të ambienteve të RTSH-së në Midë, gjë që ka shkaktuar ndërprerjen e transmetimeve të këtij subjekti prej pikës së Midës gjatë vitit 2011.

Radio Lushnja raporton se në muajt e verës janë konstatuar interferenca nga stacioni italian Radio Due, të cilat janë evituar duke ngritur me iniciativën e tyre fuqinë e transmetimit. Po kështu radio “KLEA” (94.3 MHz) raporton se interferohet nga radio “Hit FM” (93.9 MHz) që transmeton jashtë brezit të lejuar. Për interferenca nga kanalet italiane raporton edhe TV Kukësi (CH-56).

Gjithashtu, për shkak të cilësisë së dobët të transmetimit të TV “Johaniter”(transmeton pa filtra me gjithë heqjen e licencës).

TV Telesport njofton se është pajisur me studio të lëvizshme, duke siguruar lidhje direkte me të gjitha mjediset sportive në vend. Po kështu edhe NTV disponon një studio të lëvizshme me kapacitet deri në 8 kamera e pajisur me linkun portabël respektiv. Me anë të kësaj studioje janë realizuar lidhjet me pikat qendrore si kryeministria, parlamenti, presidenca etj.

4.4.2. Transmetimet numerike ekzistuese

4.4.2.1. Digitalb

Operatori Digitalb ka filluar transmetimet prej korrikut 2004 pa licencën e KKRT-së. Sot Digitalb ka stacione të instaluar në 7 pika transmetimi. Ky operator ofron një paketë programesh numerike të mbështetura në sisteme numerike tokësore (4 rrjete fikse). Kanali 29 që përdorej për transmetime DVB-H aktualisht përdoret në rajonin Tiranë-Durrës për eksperimentimin e transmetimeve numerike në sistemin DVB-T2 pa njoftuar KKRT-në.

Digitalb i licencuar si operator numerik satelitor ripërsërit një numër kanalesh që transmetohen në mënyrë tokësore.




Fig. 11 Shtrirja e mbulimit me sinjal numerik të DigitAlb




Fig. 12. Shtirja e mbulimit me sinjal numerik DVB-H (mobil) të DigitALB (kufijtë me viza të kuqe janë për ish zonën e mbulimit)

4.4.2.2. Tring

Në sistemin numerik tokësor TRING ka ndërtuar dy rrjete fikse për të cilat përdor dy kanale UHF (*Ultra High Frequency*), (kanalin 59 dhe kanalin 47), nëpërmjet stacioneve transmetues të instaluar në malin e Dajtit, duke mbuluar zonën Tiranë-Durrës.

Leja e përkohshme “Për eksperimentimin e transmetimeve numerike” e lëshuar nga KKRT më 23.01.2008 për TV Vizion+, përcakton përdorimin e kanalit 59, nëpërmjet një stacioni transmetues të instaluar në malin e Dajtit. Kjo leje e përkohshme përcakton edhe kushtin që në mbarim të afatit të përcaktuar në të, operatori duhet të paraqesë në KKRT një informacion të hollësishëm mbi rezultatet tekniko-ekonomike të eksperimentimit dhe konkluzionet përkatëse. Kjo detyrë nuk është zbatuar nga TRING, megjithëse afati i lejes së përkohshme ka përfunduar që në datën 24.07.2008.

TRING tashmë është licencuar si operator numerik satelitor. Në këtë sistem ai ripërsërit një numër kanalesh që transmetohen në mënyrë tokësore.




Fig. 13. Mbulimi me sinjal nga televizioni numerik tokësor TRING

4.4.2.3. Shijak TV

Në sistemin numerik tokësor Shijak TV ka ndërtuar një rrjet fiks, për të cilin përdor 1 kanal UHF nëpërmjet një stacioni transmetues të instaluar në malin e Dajtit, duke mbuluar zonën Tiranë-Durrës. Aktualisht për transmetimin numerik, Shijak TV përdor kanalin 24 UHF, ndërsa Leja e përkohshme “Për eksperimentimin e transmetimeve numerike” e lëshuar nga KKRT, përcakton përdorimin e kanalit 44, nëpërmjet stacioneve transmetues të instaluar në qytetin e Tiranës. Leja e përkohshme përcakton edhe kushtin që, në mbarim të afatit të përcaktuar nga kjo leje, operatori duhet të paraqesë në KKRT një informacion të hollësishëm mbi rezultatet tekniko-ekonomike të eksperimentimit dhe konkluzionet përkatëse. Kjo detyrë nuk është zbatuar nga Shijak TV, por nga të

dhënat që disponon KKRT, rezultojnë se eksperimenti nuk ka arritur rezultatet e synuara tekniko-ekonomike.




Fig. 14 Mbulimi me sinjal nga televizioni numerik tokësor Shijak

Konkluzion

Situata e transmetimeve numerike tokësore vazhdon të jetë krejtësisht e parregulluar, për pasojë e pakontrolluar. Operatorët e transmetimeve numerike tokësore, operojnë pa licenca përkatëse ku përcaktohen rregullat dhe kushtet e shërbimit, si dhe detyrimet përkatëse financiare, duke shtrembëruar tregun në dëm të operatorëve analogë të licencuar rregullisht.

Miratimi sa më i shpejtë i Strategjisë së Kalimit në Transmetimet Numerike dhe marrja e masave për licencimin e shpejtë të këtyre transmetimeve, do të vendosë rregull edhe në këtë sektor duke rritur efektivitetin e shërbimeve nëpërmjet kontrollit të zbatimit të kushteve të licencës.

4.5. Puna për përfundimin e projektit të Strategjisë së kalimit në transmetimet numerike

Siç është përmendur edhe në raportet për vitet 2009 dhe 2010, në qershor 2009, Kryeministri ka ngritur Komitetin ad hoc për strategjinë e kalimit nga transmetimet analoge në ato dixhitale. Ky komitet kryesohet nga Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit, por gjatë vitit 2011 nuk është mbledhur asnjë herë.

Pranë Komitetit ad hoc, funksionon Sekretariati Teknik, i cili mbështet punën e Komitetit. Sekretariati është i përbërë nga dy ekspertë të KKRT-së dhe dy të RTSH-së, si dhe një ekspert nga institucionet e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, AKEP-i, Zyrës Shqiptare të të Drejtave të Autorit, Televizioni Publik Shqiptar, Shoqatës së Operatorëve RTV, Zyrës për mbrojtjen e Konsumatorit, Autoritetit të Konkurrencës dhe Agjencia Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit. Me Urdhrin nr. 14, datë 22.09.2011 të Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, drejtues i Sekretariatit teknik është caktuar këshilltari i Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit

Sekretariati, gjatë vitit 2011, zhvilloi një punë intensive, që u shoqërua me debate konstruktive. Diskutimet u përqendruan në materialin bazë të paraqitur nga KKRT dhe në përfundim në nëntor 2011, Sekretariati Teknik miratoi projektin final që iu përcoll kryetarit të Komitetit *ad hoc*.



V. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE, MARRËDHËNIET ME JASHTË DHE PUBLIKUN

5.1. MENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE DHE ADMINISTRATIVE

Menaxhimi i burimeve njerëzore përmes krijimit të një administrate civile profesionale, të qëndrueshme, efektive dhe të përgjegjshme, është një nga sfidat më të rëndësishme për çdo institucion publik, duke synuar përmirësimin dhe përafrimin e sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe administrative me standardet dhe praktikën më të mira evropiane. Kjo nënkupton, në radhë të parë, përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të shërbimit civil, nëpërmjet forcimit të parimit të meritës në rekrutim, rritjen e mobilitetit dhe zhvillimit të karrierës brenda shërbimit civil, si dhe përmirësimit të sistemit të trajnimit.

Nevoja e pasjes së një administrate efikase si dhe forcimi i kapaciteteve administrative, teknike dhe financiare të Këshillit Kombëtar të Radio dhe Televizionit (KKRT), mbetet pjesë e dialogut BE-Shqipëri, në kuadër të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Më konkretisht, Raporti i fundit i Komisionit Europian (nëntor 2011), pika 4.10. Shoqëria e informacionit dhe media, thekson, ndërmjet të tjerash, se “...*Pak përparime janë bërë në fushën e politikës audiovizuale. Legjislacioni shqiptar është akoma pjesërisht i harmonizuar me standardet evropiane për rregullimin e medias dhe me Direktivën e Shërbimeve të Medias Audiovizuale. Projektligji për Shërbimet e Medias Audiovizuale ende nuk është miratuar. Është ngritur shqetësimi që disa dispozita nuk janë në përputhje me standardet evropiane të pavarësisht së autoritetit rregullator. Afati për kalimin në sistemin dixhital është shtyrë nga fundi i vitit 2012 në fund të 2015; deri tani nuk janë marrë masa konkrete për këtë kalim, si dhe nuk është miratuar ende strategjia e dixhitalizimit... Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit vazhdon të mos ketë kapacitete të mjaftueshme administrative e teknike...*”

Këto elementë, janë theksuar edhe në rekomandimet e dala nga takimi i tretë i Nën-Komitetit BE-Shqipëri “Mbi Inovacionin, Shoqërinë e Informacionit dhe Politikën Sociale”, zhvilluar më datë 30 qershor 2011, në Tiranë.

Duke vlerësuar dhe analizuar të gjithë këto elemente, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, është përpjekur të rrisë dhe përmirësojë më tej performancën e administratës së saj, në funksion të krijimit të një administrate të kualifikuar dhe efikente për të përballuar problemet dhe sfidat që dalin nga zhvillimet e reja teknologjike në fushën e medias elektronike dhe sidomos për sa i përket procesit të kalimit në sistemin numerik.

Në funksion të sa më sipër, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit miratoi me Vendimin nr. 199, datë 30.06.2011 projektstrukturën, organikën dhe numrin e punonjësve të administratës së Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit. Në

zbatim të ligjit nr. 8410 kjo projektstrukturë u dërgua për miratim në shtator 2011 në Kuvendin e Shqipërisë, por KKRT nuk ka ende një përgjigje.

Vlen të theksohet se ndryshimet e paraqitura në strukturën e propozuar, synojnë të adresojnë problematikat të cilat janë hasur gjatë veprimtarisë së përditshme të institucionit, dhe nuk kanë për qëllim një adresim të thellë dhe afat-gjatë të forcimit të kapaciteteve administrative të institucionit.

Siç është theksuar edhe më parë, ndryshimet e thella strukturore, në një linjë me filozofinë rregullatore të vendeve të Bashkimit Europian, duhet të realizohen pas miratimit të kuadrit të ri ligjor në fushën e medias elektronike. Në këtë kuadër kompetencat dhe detyrat e KKRT-së sipas një ligji të ri, do të kërkojnë serish nevojën e përcaktimit të një strukture të re të institucionit, për përballimin e sfidave që mbart procesi i kalimit në sistemin numerik.

Edhe gjatë vitit raportues, në përputhje me vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 184, datë 19.05.2008, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicionit të punës të KKRT-së” ka vazhduar puna për plotësimin e organikës së Institucionit, nëpërmjet realizimit të konkurseve në përputhje me legjislacionin në fushën e shërbimit civil.

Përfaqësues të KKRT-së, kanë marrë pjesë aktivisht në trajnimet dhe seminarët e ndryshme të organizuara nga Departamenti i Administratës Publike, Komisioni i Shërbimit Civil dhe Instituti i Trajnimit të Administratës Publike, në lidhje me aspekte të ndryshme të legjislacionit në fushën e shërbimit civil.

Vlen të përmendet pjesëmarrja dhe kontributi i dhënë në seminarin e organizuar nga Komisioni i Shërbimit Civil dhe Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, me datë 3 nëntor 2011, me temë “Zbatimi i ligjit “Statusi i nëpunësit civil” në institucionet e pavarura”, si dhe në takimin e organizuar nga Departamenti i Administratës Publike, më datë 8 nëntor 2011, në lidhje me diskutimin e projekt-ligjit të ri në fushën e shërbimit civil.

Gjatë vitit 2011, mund të konstatohet një pjesëmarrje e gjerë dhe aktive e përfaqësuesve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit në një sërë veprimtarish dhe aktiviteteve trajnuese të organizuar nga autoritetet rregullatore partnere dhe nga organizmat ndërkombëtare ku Shqipëria është palë. Pjesëmarrja në këto veprimtari dhe aktivitete trajnuese ka çuar në rritjen e efikasitetit dhe cilësisë së punës së administratës së KKRT-së, nëpërmjet njohjes me standardet dhe praktikën e ndjekura nga autoritetet partnere për çështje të ndryshme që lidhen me median elektronike dhe sidomos për sa i përket procesit të kalimit në sistemin numerik.

Një pjesë e rëndësishme e punës së administratës së KKRT-së gjatë vitit raportues, ka qenë dhe plotësimi i angazhimeve të marra në kuadër të procesit të integritimit evropian si dhe dërgimi i informacioneve të vazhdueshme pranë Ministrisë së Integritimit Evropian në lidhje me ecurinë e zbatimit të tyre.

Përfaqësuesit e KKRT-së kanë marrë pjesë aktive në takimet e organizuara me përfaqësues të Komisionit Evropian për çështjet që lidhen me politikat audiovizuale si dhe në trajnimet e organizuara nga Ministria e Integritimit Evropian, ku mund të përmendet seminari i organizuar, gjatë muajit qershor 2011, në lidhje me analizën e boshllëqeve legjislative për kapitullin 10 të Acquis “*Shoqëria e Informacionit dhe media*”, ku kanë qenë të ftuar ekspertë të huaj të kontraktuar nga Komisioni Evropian.

Pajisja me mjedise të reja pune të KKRT-së është një tjetër shqetësim që lidhet drejtpërdrejt me funksionimin normal të institucionit. Pavarësisht reagimit të vazhdueshëm për situatën në të cilën ndodhet institucioni, pas vendimit gjyqësor për lirim të ambienteve të punës dhe kthimit të tyre një subjekti privat, konstatohet me keqardhje se nuk është marrë deri më sot asnjë veprim për t'i dhënë zgjidhje këtij problemi.

Në përfundim, do të duhet të theksohen edhe masat e marra në organizimin, ndjekjen dhe realizimin e shërbimeve të ndryshme me qëllim mbarëvajtjen dhe ecurinë normale të punës, identifikimin e nevojave dhe adresimin e problematikave që lidhen me punën e përditshme të institucionit, nëpërmjet realizimit të blerjeve dhe prokurimeve të ndryshme, në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi.

5.2. MARRËDHËNIET ME JASHTË

Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe forcimi i marrëdhënieve me organizatat ndërkombëtare në fushën e medias elektronike, vazhdon të mbetet një nga prioritetet e punës së Institucionit. Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit është tashmë pjesë e disa organizmave rajonalë dhe ndërkombëtarë, të cilat synojnë forcimin e bashkëpunimit në fushën e medias, shkëmbimin e eksperiencës si dhe respektimin e standardeve europiane dhe ndërkombëtare në këtë fushë.

Edhe gjatë vitit 2011, në kuadër të bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë, të rëndësishme vazhdojnë të mbeten takimet me përfaqësues të Komisionit Evropian, në funksion të monitorimit të zbatimit të angazhimeve të Shqipërisë në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Më konkretisht, në datën 30 qershor 2011, u zhvillua në Tiranë, takimi i tretë i Nën-Komitetit BE-Shqipëri “Mbi Inovacionin, Shoqërinë e Informacionit dhe Politikën Sociale”, në axhendën e të cilit u përfshinë edhe çështjet që lidheshin me fushën e medias elektronike.

Këto çështje fokusoheshin kryesisht në:

- Përfundimin e reformës ligjore në fushën e medias elektronike
- Pavarësinë e Autoritetit Rregullator
- Forcimin e burimeve administrative dhe teknike të KKRT-së.

- Kalimin nga transmetimi analog në atë dixhital, përditësimi dhe planifikimi; dhe
- Përditësimin mbi asistencën financiare të KE-së dhe financuesve të tjerë.

Në lidhje me këto çështje, ku përfshihej puna e institucionit të KKRT-së, u bë një prezantim i plotë i zhvillimeve më të fundit në fushën e medias, ku u dha një informacion konkret në lidhje me peizazhin aktual audio-vizual, pavarësinë e autoritetit rregullator, kapacitetet teknike dhe administrative të KKRT-së, si dhe në mënyrë të veçantë në lidhje me ecurinë për hartimin e strategjisë së kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike.

Përfaqësuesit e Komisionit Evropian vlerësuan punën dhe progresin e bërë nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, duke nënvizuar në të njëjtën kohë rëndësinë që ka miratimi sa më i shpejtë i Strategjisë Kombëtare për kalimin nga sistemi analog në atë numerik, si dhe i projektligjit të ri në fushën e medias. U theksua gjithashtu, nevoja e forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve administrative dhe teknike me qëllim jo vetëm për të adresuar sfidat dhe problematikat që do të hasen gjatë procesit të kalimit në sistemin numerik, por edhe për ta sjellë autoritetin rregullator në linjë me standardet dhe praktikat më të mira evropiane.

Edhe gjatë vitit raportues, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ka vazhduar bashkëpunimin me OSBE-në, e cila vazhdon të mbetet një nga partneret me të rëndësishme në fushën e medias. OSBE ka shprehur gatishmërinë për të thelluar më tej bashkëpunimin dhe mbështetjen e saj për KKRT-në, në mënyrë të veçantë për sa i përket fazave të procesit të kalimit në sistemin numerik dhe adresimit të sfidave që ai mbart. Në këtë linjë ishte edhe kontraktimi nga OSBE-ja, gjatë muajit shtator 2011, të një eksperti të huaj për të bërë një vlerësim të plotë të projekt-strategjisë së kalimit në transmetimet numerike, me qëllim dhënien e rekomandimeve dhe sugjerimeve për përmirësimin e mundshëm të këtij dokumenti.

Një komponent i rëndësishëm i punës së KKRT-së mbetet forcimi i bashkëpunimit me autoritetet rregullatore të vendeve të tjera. Parë në këtë aspekt, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit ka thelluar më tej bashkëpunimin me autoritetet rregullatore, të vendeve fqinje dhe vendeve të tjera evropiane, të tilla si Autoriteti Rregullator i Maqedonisë, Autoriteti Rregullator i Kosovës, AGCOM (Itali), ARDCG (Mali i Zi), Autoriteti Rregullator i Sllovenisë, Autoriteti Rregullator i Turqisë, Këshilli i Lartë Audiovizual Francez etj, për çështje të ndryshme që prekin fushën e politikave audio-vizuale.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar, vlen të përmendet këtu anëtarësimi i KKRT-së në Rrjetin Frankofon të Autoriteteve Rregullatore (REFRAM). Pas paraqitjes së kërkesës zyrtare, në Konferencën e dytë të REFRAM-it, të zhvilluar në datat 19-20 shtator 2011 në Belgjikë (Bruksel), u vendos me unanimitet të plotë anëtarësimi i KKRT-së në këtë organizëm.

Në muajit gusht 2011, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit nënshkroi me Delegacionin e Komisionit Evropian në Tiranë kontratën e grantin, që i hapi rrugë zyrtarisht përfshirjes së KKRT-së në projektin rajonal “**Televizioni Dixhital i**

Europës Juglindore (SEE Digi TV)” (më shumë informacion në lidhje me këtë projekt do të gjeni më poshtë).

Edhe gjatë vitit raportues, përfaqësuesit e KKRT-së kanë qenë të pranishëm dhe kanë dhënë kontributet e tyre në shumë aktivitete dhe veprimtari të organizuara nga partnerët dhe organizmat ndërkombëtare, të tilla si:

- EPRA (Platforma Evropiane e Autoriteteve Rregullatore)
- RIRM (Rrjeti i Autoriteteve Rregullatore Mesdhetare)
- ITU (Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacioneve)
- BRAF (Autoritetet Rregullatore të Vendeve të Detit të Zi), etj

Përfaqësuesit e KKRT-së kanë qenë prezent dhe kanë dhënë kontributet e tyre në takimet e organizuara nga:

- Kompania Cullen International, zhvilluar në datën 31 janar 2011 në Bruksel (Belgjikë), me qëllim prezantimin e studimit të financuar nga Komisioni European mbi indikatorët për pavarësinë dhe funksionimin eficient të organeve rregullatore që janë përgjegjëse për shërbimet mediatike audio-vizuale. Studimi synon të ndihmojë, të gjitha entet rregullatore europiane, në problemet që ato ndeshin, lidhur me pavarësinë ekonomike dhe politike.
- Qendra Mediatike e Sarajevës, zhvilluar në datën 18-19 shkurt 2011 në Sarajevë (Bosnjë), “Konferenca rajonale mbi median e re dhe dixhitalizimin”, qëllimi i së cilës ishte analizimi i procesit të kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike në vendet e rajonit dhe shkëmbimin e eksperiencave pozitive ndërmjet këtyre vendeve.
- Autoriteti i Matjes së Audiencës Televizive, zhvilluar në datën 18 mars 2011 në Milano (Itali). Qëllimi i takimit ishte vendosja e bashkëpunimit midis KKRT-së dhe Autoritetit të Matjes së Audiencës Televizive me qëllim futjen në Shqipëri të teknologjive moderne për matjen e audiencës.
- Agjencia Elektronike e Postës dhe Komunikacionit të Republikës së Sllovenisë (APEK), zhvilluar në datat 18-19 prill 2011 në Lubjanë (Slloveni), takimi dy ditor iniciues për projektin “Televizioni Dixhital i Europës Juglindore (SEE Digi TV)”, ku partner në këtë projekt është edhe Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit.
- Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (ITU), zhvilluar në datat 2-4 maj 2011 në Gyor (Hungari), Seminari Rajonal mbi “Televizionin Dixhital Tokësor dhe Dividentin në Europën Qëndrore dhe Lindore”. Qëllimi i seminarit ishte diskutimi në nivel të lartë dhe ndarja e eksperiencave për çështje të rëndësishme si frekuencat, harmonizimi i përdorimit të spektrit, çështjet ekonomike dhe rregullatore në lidhje me kalimin nga transmetimet analoge në ato numerike dhe dividenti dixhital në Europën Qendrore dhe Lindore.
- Komisioni European, zhvilluar në datën 6 maj 2011 në Bruksel (Belgjikë), “Konferenca mbi lirinë e shprehjes dhe median në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë”. Qëllimi i Konferencës ishte diskutimi i problematikave që hasin media dhe gazetarët në Ballkanin Perëndimor si rrjedhojë e rritjes së influencës së presionit politik dhe financiar që pëson media. Gjithashtu u diskutua rreth krijimit të një fondi në nivel european për të zhvilluar më tej gazetarinë investigative.

- Autoriteti Rregullator Austriak për Transmetimin dhe Komunikimin, zhvilluar në 17-18 maj 2011 në Vjenë (Austri), “Takimi i Bordit Ekzekutiv të Projektit Digit Tv”.
- Bashkimi Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (ITU), zhvilluar në datat 19-20 maj 2011 në Gjenevë, (Zvicër), “Takimi i parë mbi interferencat e dëmshme ndaj stacioneve BC/BT të frekuencave VHF/UHF midis Italisë dhe vendeve fqinje”. Qëllimi i takimit ishte diskutimi mbi ndërhyrjet e frekuencave Italiane në frekuencat e vendeve të ndryshme si Kroacia, Mali i Zi, Shqipëria.
- Platforma Evropiane e Autoriteteve Rregullatore (EPRA), zhvilluar në datat 25-27 maj 2011 në Ohër (Maqedoni), Konferenca e 33 –të e EPRA-s ku u diskutua mbi temat kyçe që i përkasin rregullimit të medias lidhur me përmbajtjen dhe Median e Re, eksplorimin e kufijve rregullues midis Medias së Re dhe asaj tradicionale, politikat e spektrit të BE-së për dividendin dixhital, çështjet e pavarësisë së autoriteteve rregullatore etj.
- Rrjeti Mesdhetar i Autoriteteve Rregullatore (RIRM), zhvilluar në datat 23-24 qershor 2011 në Maltë, takimi i Komisionit Teknik gjatë së cilit u diskutua mbi konkluzionet e takimit të fundit plenar të RIRM-it, propozimi i draft-axhendës për takimin e rradhës, si dhe shkëmbimi i eksperiencave midis anëtarëve të RIRM-it.
- Organizata e Kombeve të Bashkuara, zhvilluar në datat 22-23 gusht 2011 në Gjenevë (Zvicër), “Takimi i Komitetit për Eleminimin e Diskriminimit Racial (CERD)”, qëllimi i së cilit ishte prezantimi i raportit mbi Konventën Ndërkombëtare “Për zhdukjen e të gjitha formave të diskriminimit racor”
- Rrjeti Frankofon i Autoriteteve Rregullatore (REFRAM), zhvilluar në datat 19-20 shtator 2011 në Belgjikë (Bruksel), “Konferenca e dytë e REFRAM”. Në këtë konferencë delegacioni i KKRT-së, paraqiti kërkesën për t’u anëtarësuar në këtë organizëm, kërkesë e cila u miratua me unanimitet të plotë.
- Agjencia për Median Elektronike, Komunikimin dhe Shërbimet Postare të Malit të Zi, zhvilluar në datat 26-27 shtator 2011 në Budva (Mal i Zi), “Takimi i dytë i Bordit Drejtues Ekzekutiv dhe Takimi i parë Teknik”, në kuadër të projektit Digi-TV. Qëllimi i takimit ishte të prezantonte rezultatet e arritura nga projekti dhe të intensifikonte zbatimin e aktiviteteve të tij në muajt në vijim.
- Platforma Evropiane e Autoriteteve Rregullatore (EPRA), zhvilluar në datat 6-7 tetor 2011 në Belgjikë (Bruksel), Konferenca e 34-ër e EPRA-s, ku u diskutua rreth rregullimit të medias së re me fokus të veçantë në shërbimet me kërkesë, mbrojtja e minorenëve dhe bashkëpunimi midis transmetuesve në Europë.
- Autoriteti Rregullator Italian, zhvilluar në datat 17-18 nëntor 2011 në Gorizia (Itali), “Takimi i Tretë i Bordit Ekzekutiv” në kuadër të projektit Digi-TV. Ky takim u fokusua në ecurinë e deritanishme të projektit si dhe aktivitetet që duhet të realizohen në të ardhmen .
- Rrjeti Mesdhetar i Autoriteteve Rregullatore (RIRM), zhvilluar në datat 24-25 nëntor 2011 në Maltë, “Sesioni i 12-të i Platformës së RIRM”. Në takim u diskutua rreth sfidave që hasin autoritetet rregullatore të mesdheut,

Reality Tv: Sjellja sociale dhe rregullatorët dhe shërbimet e reja audiovizuale.

- Këshilli i Kooperimit Rajonal dhe Komisioni Europian, zhvilluar në datat 13-14 nëntor 2011 në Sarajevë (Bosnjë), “Konferenca e Europës Juglindore mbi Kalimin nga transmetimet shtetërore në ato publike”. Qëllimi i takimit ishte analizimi i gjëndjes së shërbimeve mediatike publike gjatë 20 viteve të fundit të tranzicionit demokratik duke i kushtuar vëmendje të veçantë një plan aksioni për të ardhmen e këtyre shërbimeve për të mbështetur lirinë, pavarësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre.
- Konferenca e parë e Forumit Europian të Komuniteteve të Medias (CMFE), zhvilluar në datat 17-19 nëntor 2011 në Nikosia (Qipro), ku u diskutua rreth gjëndjes së komuniteteve mediatike në Europë, sfidave dhe mundësive që kanë këto lloj komunitetesh, studimeve kërkimore, politikave dhe praktikat më të frytshme në lidhje me komunitetet mediatike.
- Autoritetet Rregullatore të Transmetimit të Detit të Zi (BRAf), zhvilluar në datën 12 dhjetor 2011 në Tbilisi (Gjeorgji), “Takimi i dytë vjetor i Autoriteteve Rregullatore të Transmetimit të Detit të Zi”, ku u diskutua rreth aktit të themelimit të BRAf, situatës aktuale të pejsazhit audiovizual të vëndeve anëtare dhe rreth takimit të ardhshëm të rjetit i cili parashikohet të zhvillohet në Tiranë.

5.3 PJESËMARRJA NË PROJEKTIN “TELEVIZIONI DIXHITAL I EUROPËS JUGLINDORE (SEE DIGI TV)”

Me ftesë të autoritetit rregullator të Sllovenisë (APEK), KKRT është bërë pjesë e projektit “**Televizioni Dixhital i Europës Juglindore (SEE Digi TV)**”, brenda Programit të Bashkëpunimit Ndërnacional të Evropës Jug-lindore të financuar nga Bashkimi Evropian.

Qëllimi i këtij projekti është krijimi i një platforme ndërnacionale të rregullatorëve, me qëllim për të adresuar çështjet që lidhen me kalimin në transmetimet numerike si dhe koordinimin dhe përdorimin e dividendit dixhital. Vendet pjesëmarrëse në këtë projekt janë autoritetet rregullatore të Sllovenisë, Italisë, Austrisë, Hungarisë, Kroacisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Serbisë, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Shqipërisë, dhe ka një kohëzgjatje janar 2011- prill 2013.

Ky projekt synon të shpejtojë dixhitalizimin e shërbimeve të transmetimit dhe do të hapë rrugën për një zhvillim më të përhapur të shërbimeve të transmetimit të teknologjisë dhe komunikimit me bandë të gjërë (ICT). Përfshirja e partnerëve, veçanërisht transmetues dhe të industrisë, është thelbësore dhe mendohet të ketë influencë pozitive në zhvillimin e biznesit. Projekti me shtrirjen e gjatë kohore do të përpiket të zgjidhë çështje të pajsive dixhitale dhe përfshirjes sociale duke krijuar kështu mundësi të barabarta për të gjithë.

Qëllimi përfundimtar i projektit është harmonizimi i aktiviteteve të Rajonit të Evropës Jug-lindore (SEE) lidhur me përfshirjen e shërbimeve të transmetimeve dixhitale të cilat do të:

- Përshejtojnë procesin e kalimit në dixhitalizim në rajon,
- Maksimalizojnë harmonizimin e strukturës legjislative dhe teknike me procesin e dixhitalizimit të BE,
- Shmangin fragmentizimin e politikës, teknologjisë dhe tregtisë,
- Zhvillojnë strategji rajonale për përdorim optimal të spektrit të frekuencave të lira për shërbimet e reja ICT me bandë të gjërë,
- Menaxhim eficient të pajisjeve dixhitale

Projekti ka për qëllim shpërndarjen e sinjalit televiziv dhe shërbimeve të reja tek kushdo në rajonin e Evropës Jug-lindore pavarësisht nga gjinia ose përkatësia etnike. Gjithashtu projekti do të kontribuojë në qëndrueshmërinë e mjedisit pasi teknologji të reja të transmetimit dixhital në të dyja anët, si në transmetim si në marrje, ulin konsumin e energjisë elektrike në mënyrë të konsiderueshme.

Projekti “**Televizioni Dixhital i Europës Juglindore (SEE Digi TV)**”, është institucionalizuar me firmosjen e kontratës së grantit me Delegacionin e Komisionit Evropian në Tiranë, gjatë muajit gusht 2011, ndërkohë që koha e fillimit të zbatimit të tij konsiderohet muaji prill 2011. Në bazë të kontratës së nënshkruar, nga fondi total prej 68,564.33 Euro, 85% e kësaj shume financohet nga Bashkimi Evropian, ndërkohë që shumica e mbetur (rreth 10.300 Euro) do të financohet nga Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit.

Struktura e Projektit

Metodologjia e përdorur për projektin “SEE Digi-TV” synon të ofrojë një platformë të përbashkët funksionale, për një kalim efektiv dhe të koordinuar në teknologjitë e transmetimit dixhital. Synimet e saj janë:

1. Formimi gradual i njohurive të përbashkëta, bazuar në shkëmbimin e njohurive dhe eksperiencave individuale të secilit partner pjesëmarrës në këtë projekt.
2. Zhvillimi i zgjidhjeve që e bëjnë dixhitalizimin më të lehtë dhe më frytdhënës, përmes vendosjes së një bashkëpunimi më efektiv ndërmjet të gjithë partnerëve në fusha të ndryshme interesi.
3. Përkrahja e vendeve të IPA-s në përshejtimin e adoptimit të standardeve dixhitale të BE-së nëpërmjet shkëmbimit të eksperiencës.
4. Trajtimi i çështjeve të mundshme të kalimit nga transmetimet analoge në numerike.
5. Përmirësimi i komunikimit dhe ndërveprimit ndërmjet gjithë partnerëve.

Për një performancë efektive, janë identifikuar 4 (katër) fusha (kuadro) tematikë: kuadri ligjor, teknik, ekonomik dhe ndërgjegjësimi publik, janë përcaktuar për të adresuar të gjithë aktivitetet e projektit sipas një linje të qartë dhe të efektshme.



Kuadri Ligjor

Projekti do të përqendrohet në hartimin e udhëzuesve rajonalë për dixhitalizimin që do të përafrohet me legjislacionin e BE-së dhe implementimin e tyre brenda kuadrit ligjor kombëtar. Dokumentet do të paraqesin opsionet për shfrytëzimin e dividendit dixhital në rajon dhe udhëzimet për vendosjen e shërbimeve të reja të transmetimeve të cilat duhet të zvogëlojnë hendekun dixhital.

Kuadri Teknik

Projekti do të fokusohet në aspektet teknike të dixhitalizimit dhe përdorimin e mundshëm të dividendit dixhital. Ndikimi i përdorimit të teknologjive të ndryshme të transmetimit, do të vlerësohet duke marrë parasysh planifikimin e kapacitetit/shërbimit (vendosjen e programit, llojet e shërbimit) kohën e kalimit në transmetimet numerike, përmirësimet e ardhshme dhe pranimin nga konsumatori në mënyrë që të shmanget fragmentimi teknik i transmetimeve dixhitale në rajon. Do të zhvillohen një sërë rekomandimesh teknike për përdorimin e pajisjeve të transmetimit.

Kuadri Ekonomik

Aspektet ekonomike të procesit të kalimit nga transmetimi analog në atë numerik, janë esenciale kur zbatohen paketat e tjera të punës, të tilla si kuadri legjislativ dhe kuadri teknik. Duhet të adresohen vendime të rëndësishme në lidhje me tregun: të tilla si mundësitë për zhvillimin e tij dhe marketingu i shërbimeve ekzistuese dhe të reja. Ndër aktorët më të rëndësishëm në këtë proces janë ofruesit e shërbimeve dhe operatorët e rrjeteve të cilët, kërkojnë mundësinë e zhvillimit të bizneseve të tyre.

Kuadri i ndërgjegjësimit publik

Ndërgjegjësimi i konsumatorit është një faktor vendimtar, i cili përcakton procesin e dixhitalizimit ose çdo proces tjetër që lidhet me futjen e shërbimeve dhe teknologjive të reja. Prandaj, programi i ndërgjegjësimit publik i cili duhet të informojë dhe edukojë konsumatorët dhe përdoruesit rreth vazhdimësisë së dixhitalizimit dhe veprimeve të nevojshme, duhet të jetë i planifikuar me kujdes. Partnerët duhet të ndajnë eksperiencat dhe praktikatat më të mira në projektimin

efektiv të fushatave ndërgjegjëse. Bazuar në eksperiencat e përbashkëta ata duhet të zhvillojnë një sërë mjetesh promovimi efektive për ndërgjegjësimin e publikut.

5.4 MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE GRUPET E INTERESIT

Një nga pikësynimet kryesore të institucionit është edhe zgjerimi i komunikimit me publikun, konsumator i produktit radioteleviziv, lidhur me respektimin e normave etike e morale nga subjektet e licencuara prej KKRT-së dhe informimi në lidhje me ecurinë e procesit të dixhitalizimit në vendin tonë. Është e rëndësishme që publiku të sensibilizohet hap pas hapi me detyrimet që kanë subjektet mediatike ndaj tij, veçanërisht në respektimin e etikës.

Gjatë vitit 2011, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit i ka kushtuar një vëmendje të veçantë krijimit të një sistemi komunikimi sa më efektiv me të gjithë aktorët që i përkasin fushës së medias, përmes faqes së internetit, e cila është riformatuar dhe tashmë përmban një paraqitje të re, në të cilën pasqyrohen të gjitha vendimet e marra nga KKRT-ja, veprimtaritë kryesore të zhvilluara brenda dhe jashtë vendit, informacion të plotë rreth projektit “Televizioni Dixhital i Europës Juglindore” etj.

Në kuadër të ndërgjegjëimit të publikut në lidhje me procesin e dixhitalizimit, në projekt strategjinë për kalimin në transmetimet numerike, në analogji me eksperiencën e vendeve të tjera, është parashikuar krijimi i një strukture për informimin e publikut. Në këtë kuadër, faqja zyrtare e KKRT-së, si dhe të gjitha strukturat përkatëse të institucionit, do të japin kontributin e tyre në lidhje me ndërgjegjësimin e publikut për sa i përket procesit të dixhitalizimit nëpërmjet komunikimeve të vazhdueshme përmes internetit dhe mjeteve të tjera të medias.



VI. BUXHETI DHE REALIZIMI I TREGUESVE FINANCIARË

Në zbatim të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9742, datë 28.05.2007 “Për transmetimet numerike në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 9975, datë 19.05.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe dispozitat e tjera ligjore të zbatueshme në fushën e ekonomisë dhe të financave, Drejtoria Ekonomike në KKRT ka punuar në drejtim të njohjes së situatës ekonomike e financiare të aktivitetit dhe funksionimit racional të administratës së KKRT-së.

6.1. REALIZIMI I OBJEKTIVAVE KRYESORE TË PUNËS PËR VITIN 2011

Këshilli i Ministrave, me Vendimin nr. 68, datë 02.02.2011 “Për miratimin e fondit limit të shpenzimeve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, për vitin 2011”, miratoi në limite fondin dhe strukturën e shpenzimeve për vitin 2011.

Treguesit financiarë për vitin 2011, ishin sipas strukturës, si më poshtë:

Nr.	EMËRTIMI	Në milionë lekë
1	Të ardhura të krijuara në vitin 2011	86.05
2	Shpenzime korente	77.06
3	Shpenzime për investime	12.01

Treguesit kryesore për krijimin e të ardhurave të institucionit janë detyrimet e operatorëve radiotelevizivë, që rrjedhin nga zbatimi i legjislacionit përkatës.

Përlllogaritja e detyrimeve financiare për operatorët radiotelevizivë bëhet mbi bazën e pagesave vjetore për licencë, të taksave për shërbimet radiotelevizive, të llogaritura mbi bazën e treguesve, të numrit të popullsisë sipas zonave të licencimit, numrit të transmetuesve të operatorëve dhe fuqisë së rrezatimit të tyre.

- Realizimi i treguesve financiarë – TË ARDHURAT

Struktura e zërit “Të Ardhura”, e parashikuar dhe e realizuar për vitin 2011, paraqitet:

Në milion lekë

Nr	Zërat e të ardhurave	Plani	Realizimi	Në %
1	Të ardhura nga pagesat vjetore për licencë	80.15	46.83	58
	Nga këto:			
	a) Të ardhura të faturuara	80.15	46.83	58
	Pagesa për licencë nga operatorët analogë Radio Tv	39	27.03	69
	Pagesa për licencë nga operatorët tokësorë e kabllorë	29.9	16.05	54
	Pagesa për licencë nga operatorët e platformës numerike satelitore	11.25	3.75	33
2	Të ardhura nga pagesa për marrjen e licencës dhe rinovimin e licencës nga:	1.8	1.52	84
	a) Operatorët analogë tokësorë Radio Tv dhe kabllorë	1.8	1.52	84
3	Të ardhura nga përpunimi i dokumenteve të licencës	1.8	1.55	86
4	Të ardhura nga përfitimet si agjent tatimor	1.2	0.762	64
5	Të ardhura nga interesa bankare për depozitat në bankë	1	0.257	26
6	Të ardhura të tjera	0.1	0.064	64
7	Të ardhura të viteve të kaluara		10.23	
	Gjithsej Të ardhura	86.05	61.213	71

- Realizimi i zërit “Të ardhura nga pagesa vjetore për licencë dhe pagesa për marrjen e licencës”.

Të ardhurat e faturuara nga pagesat për licencë nga operatorët radiotelevizivë, **analogë tokësorë e kabllorë**, si dhe nga **pagesat për licencë për platformat numerike satelitore** për vitin 2011, të planifikuara në masën prej 86.05 milionë lekë, janë realizuar në masën prej 61.21 milionë lekë ose 71 %. Nga realizimi i të ardhurave të mësipërme, 51 milionë lekë janë të ardhura nga faturat e pagesave për licencë për vitin 2011 dhe 10.22 milionë lekë nga të ardhurat e faturuara në vitin 2010. Realizimi prej 58 % i pagesave të faturuara në vitin 2011, vjen si rezultat i afatit vjetor të pagesës për licencë. Nga 242 operatorë të cilët operojnë në fushën e mediave vizive, kanë kryer pagesat për licencë 136 prej tyre, nga të cilët, 46 operatorë radiofonik, 40 operatorë televizivë, 49 operatorë me kabëll dhe 1 nga operatorët e platformës numerike satelitore. Në bazë të periudhës së licencimit rreth 60% e operatorëve e kanë afatin përfundimtar të shlyerjes së pagesave vjetore të vitit 2011 në gjashtëmujorin e parë ose të dytë të vitit 2012.

Nisur nga afati ligjor i shlyerjes së detyrimeve në bazë të vitit të licencimit, gjatë vitit 2011 janë arkëtuar edhe detyrime të vitit 2010, në masën prej 10.22 milionë lekë dhe kanë mbetur pa u shlyer dhe 23 milionë lekë (Aneksi IV).


Të ardhurat për marrjen dhe rinovimin e licencës janë realizuar në shumën 1.52 milionë lekë ose 84%, nga përpunimi i dokumenteve për marrjen dhe rinovimin e

licencave 1.55 milionë lekë ose 86%, nga agjenti tatimor në shumën prej rreth 0.76 milionë lekë ose 64%, nga interesa bankare 0.257 milionë lekë ose 26% dhe të ardhura të tjera 0.06 milionë lekë ose 63%.


Për sa më lart, gjatë vitit 2011, në llogarinë e KKRT janë arkëtuar të ardhura në shumën prej **61.212 milionë lekë**.

Gjithashtu për vitin 2011 u bë i mundur financimi i projektit “SEE TV DIGI” në shumën **46.553 Euro** (ky është një projekt disavjeçar i bashkëfinancuar nga Komisioni Europian).


Në fushën e mediave elektronike, për vitin 2011, kanë qenë aktivë 242 operatorë, të klasifikuar sipas llojit të aktivitetit si më poshtë:



Të ardhurat e realizuara nga shlyerja e detyrimeve financiare të pagesave për licencë



Krahasuar me nivelet e të ardhurave të planifikuara, realizimi i të ardhurave nga pagesat për licencë arrin në rreth 58%. I detajuar, realizimi nga operatorët radio është 69%, nga operatorët TV me frekuencë 76%, nga operatorët TV kabllorë me 59.9% dhe nga operatorët e platformës numerike satelitore 33.3 %.



Pagesat e mbartura prej 10.225 milionë lekë nga viti paraardhës, krijohen pasi pagesa vjetore për licencë llogaritet për vit licencimi, të cilat faturohen në vitin paraardhës, por paguhet në vitin pasardhës. Një shkak tjetër është neglizhenca e operatorëve për shlyerjen në afat të detyrimeve. Për penalizmin e këtyre rasteve, operatorët merren në konsideratë nga KKRT, duke marrë masat përkatëse, deri në shpalljen e pavlefshmërisë së licencës.

- Të ardhurat nga agjenti tatimor – Taksat për shërbimet RTV
Ligji nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për sistemin e taksave në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ngarkon KKRT, në rolin e agjentit tatimor, për transferimin në buxhetin e shtetit të taksës vjetore për shërbimet RTV të subjekteve. Për këtë shërbim, KKRT përfiton 5% të vlerës së arkëtuar dhe të transferuar në buxhetin e shtetit.
Për vitin 2011 shlyerja e detyrimeve të taksave për shërbimet radiotelevizive nga subjektet radiotelevizive është kryer në masën 61%.

Për vitin 2011 janë transferuar në buxhetin e shtetit 15.258 milionë lekë, nga të cilat 10.06 milionë lekë taksa për shërbimet RTV, detyrime të vitit 2011 dhe 5.2 milionë lekë detyrime të vitit 2010. Nga KKRT-ja si agjent tatimor janë përfituar 0.76 milionë lekë.

Të ardhurat nga interesat bankare për fondet e depozituara në bankë për periudhën Janar – Dhjetor 2011 janë rreth 0.257 milionë lekë.

KKRT, për zhvillimin normal të aktivitetit ka përdorur fondet e faturuara në vitin 2011, që janë arkëtuar në llogarinë e KKRT-së si dhe fondet e akumuluar në vitet e kaluara, që janë depozituar në llogarinë e KKRT-së, sipas analizës së mëposhtme:

- Realizimi i treguesve financiarë – SHPENZIMET

Këshilli i Ministrave, me Vendimin nr. 68, datë 02.02.2011, "Për miratimin e fondit limit të shpenzimeve të Këshillit Kombëtar të Radios dhe Televizionit, për vitin 2011", miratoi fondin limit të shpenzimeve për vitin 2011 të detajuar si më poshtë:

Shpenzime korente	77.06	milione lekë
Shpenzime për investime	12.01	milione lekë
Gjithsej	89.07	milione lekë

Për periudhën Janar – Dhjetor 2011 realizimi i shpenzimeve sipas strukturës paraqitet:

mil/lekë

Nr.	Emërtimi i Shpenzimeve	Plan	Realizim	%
1.	Shpenzime korente (operative)	77.06	68.95	89
	a) Paga e kontribute	56.3	51.55	92
	b) Shpenzime materiale e të tjera	20.76	17.4	84
2.	Shpenzime për investime	12.01	8.1	67
	a) Blerje pajisje zyre dhe kompjuterike	3.41	3.066	90
	b) Blerje pajisje operationale specifike	3.6	0.076	2
	c) Blerje autovetura	5	4.9	98
3.	Shpenzime të paparashikuara		6.1	

Shpenzime operative

Shpenzimet operative janë realizuar në masën prej 68.95 milionë lekë ose 89 % e shumës së planifikuar. Realizimi në këtë masë ka ardhur për arsye se:

A) Realizimi i zërit "Paga e kontribute të tjera" në masën 92% ka ardhur si rrjedhojë e lëvizjes të disa punonjësve gjatë vitit 2011 si dhe zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 545, datë 11.08.2011 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucioneve të pavarura, institucione në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrive të linjës dhe administratën e Prefektit", në bazë të të cilit janë hequr pagesat për gradat shkencore (doktoraturë, master) që përfitonin punonjësit e KKRT-së.

Po kështu në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 463, datë 16.06.2011 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 511, datë 24.10.2002 "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore", nuk janë kryer pagesat për orët e punës jashtë orarit dhe gjatë ditëve të pushimit.

B) Realizimi në masën 84 % të zërit "Shpenzime materiale e të tjera", gjatë vitit 2011, ka ndodhur pasi:

Shpenzimet për honorare, janë realizuar në masën 1.3 milionë lekë ose 43%, për arsye të mungesës gjatë vitit 2011 të një anëtarit të KKRT-së, të mungesës prej 5 muaj të një anëtarit të dytë në KKRT, si dhe nga mosfunksionimi i Këshillit të Ankesave gjatë vitit 2011.

Si rezultat i mungesës së Këshillit të Ankesave nuk është shpenzuar edhe fondi i planifikuar për Botimin e buletinit të KKRT-së.

Në mënyrë grafike realizimi i shpenzimeve për vitin 2011, paraqitet si vijon:




Në vitin 2011, përveç shpenzime të sipërpërmendura, të cilat ishin miratuar në buxhetin e KKRT-së, janë kryer dhe 6.1 milionë lekë shpenzime të paparashikuara, në bazë të titujve ekzekutive, të vendimeve gjyqësore, sipas proceseve gjyqësore ku KKRT ka qene palë.

Në zbatim të projektit “SEE Digi Tv” dhe në bazë të kontratës nr. 2001/269-228, datë 12.08.2011, të nënshkruar ndërmjet KKRT-së dhe Delegacionit të Bashkimit Europian Tiranë, janë kryer dhe shpenzime në masën 0.691 milionë lekë.

Shpenzimet për investime

Ky tregues është realizuar në masën 8.06 milion lekë ose 67% sipas strukturës së mëposhtme.



Së pari, u krye “Blerja e pajisje zyre dhe kompjuterike” në masën 3.07 milionë lekë nga 3.41 milionë lekë që ishin planifikuar


Së dyti, u krye “Blerja e dy autoveturave” të planifikuara në masë 4.9 milionë lekë nga 5 milionë lekë të planifikuara.

Së treti, blerja e pajisjeve operationale specifike nuk u realizua në masën 3.52 milionë lekë. Ky mosrealizim erdhi si rezultat i pamjaftueshmërisë së fondit të planifikuar.

- Pasqyrat financiare të operatorëve radiotelevizivë

Në zbatim të nenit nr. 48 të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, KKRT ka kërkuar nga operatorët radiotelevizivë, të cilët kanë pasur aktivitet për vitin 2010, të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore, të hartuara në përputhje me legjislacionin për kontabilitetin dhe të konfirmuara me numrin dhe datën e dërgesës postare.

Në mbyllje të vitit 2011, nga 220 operatorë të cilët kanë pasur aktivitet gjatë vitit 2010, 104 prej tyre kanë dorëzuar pasqyrat financiare të vitit 2010 ose 47 % e operatorëve. Nga këta, kanë depozituar pasqyrat financiare 31 operatorë radio, 41 operatorë TV, 31 operatorë TV me kabëll dhe 1 operator televiziv numerik. Situata financiare e operatorëve që kanë dorëzuar pasqyrat financiare rezultojnë se 20 operatore ose 19%, janë me humbje, 6 operatorë ose 6 % kanë rezultat financiar zero, ndërsa 78 operatore ose 75 % janë me rezultat financiar pozitiv.



Nga analiza e treguesve financiarë të operatorëve RTV peshën specifike të të ardhurave e zë zëri “Të ardhurat nga reklamat”.

6.2. GJOBAT

Neni 137 i ligjit nr. 8410 i jep të drejtën KKRT-së të vendosë sanksione administrative për shkeljen e dispozitave detyruese të ligjit. Gjatë vitit 2011, janë vendosur **120** sanksione – gjoba, në vlerën 68.90 milionë lekë. Mbas ankimit administrativ që operatorët kanë bërë pranë KKRT-së, KKRT ka ndryshuar masën e gjobës dhe mbas këtyre ndryshimeve vlera e gjobave është 34.11 milionë lekë. Janë vjelë dhe transferuar në buxhetin e shtetit 1.4 milionë lekë. Për ekzekutimin e vendimeve lidhur me gjobat, KKRT ka bashkëpunuar me Policinë Tatimore dhe me Drejtoritë Rajonale të Tatimeve (Aneksi V).

6.3. BASHKËPUNIMI ME DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË TATIMEVE

Në zbatim të ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar, të Udhëzimit nr. 36, datë 11.11.2008 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimeve e transmetimeve radiotelevizive” dhe të “Marrëveshjes së Bashkëpunimit”, datë 01.01.2011, KKRT ka bashkëpunuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për ekzekutimin e vendimeve dhe urdhrave të KKRT, për sanksionet e vëna dhe për vjeljen e detyrimeve të pashlyera nga subjektet radiotelevizivë. Pavarësisht nga sa më sipër, vjelja e detyrimeve prej Drejtorive Rajonale të Tatimeve nuk është kryer si duhet.

Me gjithë korrespondencën e vazhdueshme shkresore me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, si dhe njoftimet e vazhdueshme Ministrisë së Financave, për shlyerjen e detyrimeve të licencës dhe taksave nga ana e kësaj Drejtorie, angazhimi ka qenë minimal.



VII. KONKLUSIONE

Në mbyllje të këtij Raporti Vjetor do të theksonim si më thelbësore konkluzionet e mëposhtme:

- Miratimi i dy dokumenteve bazë, të cilat do të përcaktojnë modalitetet dhe mënyrat e kalimit në sistemin numerik:
 - a. Strategjia e kalimit nga transmetimet analoge në ato numerike
 - b. Projektligji “ Për transmetimet audiovizive në Republikën e Shqipërisë” duhen bërë sa më shpejt. Vonesa në këtë drejtim do të shkaktojë mosrespektimin e afateve të përcaktuara ndërkombëtarisht në lidhje me kalimin në sistemin numerik.
- Miratimi i një strukture më efektive të KKRT-së (veçanërisht në rast miratimi të projektligjit për mediat audiovizive), në një linjë me filozofinë rregullatore të vendeve të Bashkimit Evropian, dhe e aftë të përballojë dhe zbatojë detyrimet që rrjedhin nga Direktiva e Shërbimeve të Medias Audiovizuale (AVMSD) si dhe nga vetë procesi i kalimit në sistemin numerik.
- Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve teknike dhe monitoruese të KKRT-së për të menaxhuar dhe zgjidhur problemet dhe çështjet që hasen si pasojë e zhvillimeve teknologjike në fushën e medias, si dhe për përballimin e sfidave që mbart procesi i kalimit në sistemin numerik.
- Licencimi i operatorëve numerikë tokësorë mbetet një detyrë e rëndësishme, jo vetëm si detyrim ligjor, por edhe në kuadrin e sigurimit të burimeve të financimit të KKRT-së, në kushtet kur KKRT nuk financohet më nga buxheti i shtetit.
- Forcimi i mëtejshëm i bashkëpunimit me Zyrën Shqiptare të të Drejtave të Autorit dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, si për respektimin e të drejtave të transmetimit, ashtu edhe për ekzekutimin e vendimeve të KKRT-së.
- Pajisja me mjedise të reja pune të KKRT-së, që lidhet drejtpërdrejt me funksionimin normal të institucionit, është një tjetër problematikë, që vazhdon të kërkojë një zgjidhje të shpejtë pas vendimeve të Gjykatave që ua kthejnë ambientet ekzistuese subjekteve të tjerë.

ANEKSET

ANEKSI 1

SANKSIONET NDAJ SUBJEKTEVE

Nr	Subjekti	Nr. i gjobës	Data e gjobës	Baza ligjore	Vlera (lekë)		
1	TV Kabllor Toshkëz	326	12.01.2011	137/4, pika 7	600.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 60 dt. 11.02.2011
							(nga 600.000 lekë në sanksion paralajmërimi)
2	TV Kabllor Pupa	327	12.01.2011	137/4, pika 7	600.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 59 dt. 11.02.2011
							(nga 600.000 lekë në sanksion paralajmërimi)
3	TV Kabllor Kombi	328	12.01.2011	137/4, pika 7	600.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 54 dt. 11.02.2011
							(nga 600.000 në 500.000 lekë)
4	TV Kabllor Irla	329	12.01.2011	137/4, pika 7	600.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 50 dt. 11.02.2011
							(nga 600.000 në 200.000 lekë)

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT

5	TV Kabllor Krutja	330	12.01.2011	137/4, pika 7	600.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 58 dt. 11.02.2011
							(nga 600.000 lekë në sanksion paralajmërimi)
6	TV Kabllor APT	331	12.01.2011	137/4, pika 7	600.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 64 dt. 11.02.2011
							(nga 600.000 lekë në sanksion paralajmërimi)
7	TV Kabllor Jug	332	12.01.2011	137/4, pika 7	800.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 57 dt. 11.02.2011
							(miratuar)
8	TV Kabllor Ura Vajguore	333	12.01.2011	137/4, pika 7	300.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 52 dt. 11.02.2011
							(nga 300.000 lekë në sanksion paralajmërimi)
9	TV Kabllor Poliçan	334	12.01.2011	137/4, pika 7	400.000		
10	TV Kabllor Iliria	335	12.01.2011	137/4, pika 7	200.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 53 dt. 11.02.2011

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVIZIONIT

							(nga 200.000 lekë në sanksion paralajmërimi)
11	TV Kabllor Divjaka	336	12.01.2011	137/4, pika 7	300.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 56 dt. 11.02.2011
							(nga 300.000 lekë në sanksion paralajmërimi)
12	TV Kabllor Kuçova	337	12.01.2011	137/4, pika 7	400.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 51 dt. 11.02.2011
							(nga 400.000 lekë në sanksion paralajmërimi)
13	TV Vendor Jug	338	19.01.2011	137/4, pika 3/c	1.000.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 61 dt. 11.02.2011
							(miratuar)
14	TV Vendor AVN	339	19.01.2011	137/4, pika 3/a	1.000.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 62 dt. 11.02.2011
							(nga 1.000.000 në 500.000 lekë)
15	TV Vendor Apollon	340	19.01.2011	137/4, pika 3/a	1.000.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 63 dt. 11.02.2011

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT

							(nga 1.000.000 në 700.000 lekë)
16	TV Kabllor Përmeti	341	27.01.2011	137/4, pika 7	800.000		
17	TV Kabllor Alfa Cable	342	27.01.2011	137/4, pika 7	600.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 55 dt. 11.02.2011
							(miratuar)
18	TV Vendor Club	343	09.02.2011	137/4, pika 7	800.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 75 dt. 25.02.2011
							(nga 800.000 lekë në sanksion paralajmërimi)
19	TV Vendor Supersonic	344	09.02.2011	137/4, pika 7	800.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 76 dt. 25.02.2011
							(nga 800.000 lekë në sanksion paralajmërimi)
20	TV Vendor BBF	345	09.02.2011	137/4, pika 7	800.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 74 dt. 25.02.2011
							(nga 800.000 lekë në sanksion paralajmërimi)
21	TV Kabllor Kombi	346	17.02.2011	137/4, pika 3/c	800.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 77 dt. 25.02.2011

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVIZIONIT

	(për komunën Levan)						(nga 800.000 lekë në sanksion paralajmërimi)
22	TV Kabllor Delvina	347	22.02.2011	137/4, pika 7	400.000	Ankuar	Shqyrtuar gjëbja me V. nr. 130 dt. 28.03.2011
							(nga 400.000 në 200.000 lekë)
23	TV Kabllor Kamza	348	22.02.2011	137/4, pika 7	800.000		
24	TV Kabllor S3 Vora	349	22.02.2011	137/4, pika 7	400.000		
25	TV Kabllor Erzeni	350	22.02.2011	137/4, pika 7	400.000	Ankuar	Shqyrtuar gjëbja me V. nr. 133 dt. 28.03.2011
							(nga 400.000 në 200.000 lekë)
26	TV Kabllor JU-AL	351	22.02.2011	137/4, pika 7	400.000	Ankuar	Shqyrtuar gjëbja me V. nr. 253 dt. 03.10.2011
							(nga 400.000 në sanksion paralajmërimi)
27	TV Kabllor Asparag	352	22.02.2011	137/4, pika 7	400.000	Ankuar	Shqyrtuar gjëbja me V. nr. 128 dt. 28.03.2011
							(nga 400.000 në 200.000 lekë)

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT

28	TV Kabllor Mirdita	353	22.02.2011	137/4, pika 7	800.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 132 dt. 28.03.2011
							(nga 800.000 në sanksion paralajmërimi)
29	TV Kabllor Luna	354	22.02.2011	137/4, pika 7	400.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 271 dt. 30.11.2011
							(nga 400.000 në 200.000 lekë)
30	TV Kabllor AL-TE	355	22.02.2011	137/4, pika 7	1.000.000		
31	TV Kabllor Blu Kabëll	356	22.02.2011	137/4, pika 7	400.000		
32	TV Kabllor Multivizion	357	24.02.2011	137/4, pika 7	300.000		
33	TV Real	358	03.03.2011	137/4, pika 7	800.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 274 dt. 30.11.2011
							(Lënë në fuqi)
34	TV Kabllor Irla	359	03.03.2011	137/4, pika 7	400.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 134 dt. 28.03.2011
							(nga 400.000 në sanksion paralajmërimi)

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT

35	TV Kabllor "IR-GEN"	360	03.03.2011	137/4, pika 7	400.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 129 dt. 28.03.2011
							(nga 400.000 në 200.000 lekë)
36	TV Kabllor Kucova	361	03.03.2011	137/4, pika 7	400.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 131 dt. 28.03.2011
							(nga 400.000 në 200.000 lekë)
37	TV Kabllor Fokus	362	03.03.2011	137/4, pika 7	200.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 136 dt. 28.03.2011
							(nga 200.000 në sanksion paralajmërimi)
38	TV Kabllor Polican	363	03.03.2011	137/4, pika 7	800.000		
39	TV Kabllor Iliria	364	17.03.2011	137/4, pika 7	600.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 146 dt. 29.04.2011
							(nga 600.000 në 200.000 lekë)
40	TV Kabllor AVN	365	17.03.2011	137/4, pika 4	1.000.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 135 dt. 28.03.2011
							(nga 1.000.000 në 50.000 lekë)
41	TV Kabllor Kombi	366	17.03.2011	137/4, pika 2/dh	1.000.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 137 dt. 28.03.2011

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT

							(nga 1.000.000 në 60.000 lekë)
42	TV Kabllor Lushnja	367	08.04.2011	137/4, pika 7	800.000	Ankuar	Shqyrtuar gjëbja me V. nr. 147 dt. 29.04.2011
							(nga 800.000 në 200.000 lekë)
43	TV Kabllor Dushk	368	08.04.2011	137/4, pika 7	400.000	Ankuar	Shqyrtuar gjëbja me V. nr. 149 dt. 29.04.2011
							(nga 400.000 në 200.000 lekë)
44	TV Kabllor Pupa	369	08.04.2011	137/4, pika 7	400.000	Ankuar	Shqyrtuar gjëbja me V. nr. 179 dt. 31.05.2011
							(nga 400.000 në 200.000 lekë)
45	TV Kabllor Tërbuf	370	08.04.2011	137/4, pika 7	400.000	Ankuar	Shqyrtuar gjëbja me V. nr. 148 dt. 29.04.2011
							(nga 400.000 në 200.000 lekë)
46	TV Kabllor Vlora Cable	371	08.04.2011	137/4, pika 7	800.000	Ankuar	Shqyrtuar gjëbja me V. nr. 150 dt. 29.04.2011
							(nga 800.000 në 200.000 lekë)
47	TV Kabllor Krutja	372	08.04.2011	137/4, pika 7	400.000		

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT

48	TV Kabllor Ura Vajgurore	373	21.04.2011	137/4, pika 7	200.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 178 dt. 31.05.2011
							(nga 200.000 në sanksion paralajmërimi)
49	TV Kabllor Erzeni	374	21.04.2011	137/4, pika 7	400.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 176 dt. 31.05.2011
							(nga 400.000 në 200.000 lekë)
50	TV Kabllor Portëz	375	21.04.2011	137/4, pika 7	400.000		
51	TV Kabllor Pojan	376	21.04.2011	137/4, pika 7	600.000		
52	TV Kabllor Roskovec	377	21.04.2011	137/4, pika 7	600.000		
53	TV Kabllor AL-TE	378	22.04.2011	137/4, pika 4	1.000.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 177 dt. 31.05.2011
							(nga 1.000.000 në 300.000 lekë)
54	TV Kabllor Mirdita (Lisssus)	379	22.04.2011	137/4, pika 2/dh	1.000.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 175 dt. 31.05.2011
							(nga 1.000.000 në 200.000 lekë)

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT

55	TV Kabllor Cakran	380	27.05.2011	137/4, pika 7	600.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 197 dt. 30.06.2011
							(nga 600.000 në 200.000 lekë)
56	TV Kabllor Kuçova	381	27.05.2011	137/4, pika 7	600.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 195 dt. 30.06.2011
							(nga 600.000 në 200.000 lekë)
57	TV Kabllor Kukësi	382	27.05.2011	137/4, pika 7	200.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 193 dt. 30.06.2011
							(nga 200.000 në sanksion paralajmërimi)
58	TV Kabllor Fraholli	383	27.05.2011	137/4, pika 7	400.000		
59	TV Kabllor Kamza	384	27.05.2011	137/4, pika 7	800.000		
60	TV Kabllor Përrenjas	385	27.05.2011	137/4, pika 7	200.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 192 dt. 30.06.2011
							(nga 200.000 në sanksion paralajmërimi)
61	TV Kabllor Asparag	386	27.05.2011	137/4, pika 7	600.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 200 dt. 30.06.2011

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT

							(nga 600.000 në sanksion paralajmërimi)
62	TV Shijak	387	01.06.2011	137/4, pika 7	300.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 199 dt. 30.06.2011
							(nga 300.000 në 200.000 lekë)
63	TV Koha	388	01.06.2011	137/4, pika 7	300.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 198 dt. 30.06.2011
							(nga 300.000 në 200.000 lekë)
64	Club TV	387/1	06.06.2011	137/4, pika 7	300.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 196 dt. 30.06.2011
							(nga 300.000 në 200.000 lekë)
65	TV Vizion +	388/1	06.06.2011	137/4, pika 7	300.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 194 dt. 30.06.2011
							(nga 300.000 në sanksion paralajmërimi)
66	Radio Alsat 1	389/1	10.06.2011	137/4, pika 2/d	200.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 201 dt. 30.06.2011
							(nga 200.000 në 100.000 lekë)

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVISIONIT

67	TV Kabllor Brado	389	01.07.2011	137/4, pika 7	400.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 217 dt. 25.07.2011
							(nga 400.000 në sanksion paralajmërimi)
68	TV Kabllor Devi ERI	390	01.07.2011	137/4, pika 7	300.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 224 dt. 01.08.2011
							(nga 300.000 në sanksion paralajmërimi)
69	TV Kabllor Asparag	391	01.07.2011	137/4, pika 7	200.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 216 dt. 25.07.2011
							(nga 200.000 në sanksion paralajmërimi)
70	TV Kabllor Krutja	392	01.07.2011	137/4, pika 7	400.000		
71	TV Kabllor Kucova	393	01.07.2011	137/4, pika 7	400.000		
72	TV Kabllor Lushnja	394	01.07.2011	137/4, pika 7	600.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 219 dt. 25.07.2011
							(nga 600.000 në sanksion paralajmërimi)
73	TV Kabllor Alfa Hajdini	395	01.07.2011	137/4, pika 3/c	1.000.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 226 dt. 01.08.2011

KËSHILLI KOMBËTAR I RADIOS DHE TELEVIZIONIT

							(nga 1.000.000 në sanksion paralajmërimi)
74	TV Kabllor Elba-Sat	396	01.07.2011	137/4, pika 7	1.000.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 218 dt. 25.07.2011
							(nga 1.000.000 në 200.000 lekë)
75	Radio Ime	397	12.07.2011	137/4, pika 3/c	1.000.000	Ankuar	Shqyrtuar gjoba me V. nr. 225 dt. 01.08.2011
